



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në**

**“Histori-Gjeografi”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë,**

**Universiteti “Fan.S.Noli”, Korçë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

**Dr. Nevila ÇINAJ**

**Prof.Asoc.Dr. Çlirim DURO**

Prill 2022

## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Fan.S.Noli" në Korçë (UK) është një institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar me VKM Nr.5, datë 07.01.1992 "Për krijimin e Universitetit të Korçës".

Ky institucion është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit (BA), me Nr. 65, datë 21.09.2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike dheme vlefshmëri deri më **30/09/2022**.

UK përbëhet nga 4 njësi kryesore, Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, Fakulteti i Bujqësisë dhe Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë përbëhet nga :



- *Departamenti i Historisë-Gjeografisë*
- *Departamenti i Gjuhëve të Huaja*
- *Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë*
- *Departamenti i Histori- Gjeografisë*

Universiteti "Fan.S.Noli" në Korçë (UK), për vitin akademik 2020-2021, ka pasur aktive 58 programe studimi në total, nga të cilat, 7 janë programe dyvjeçare, 26 programe Bachelor, 21 programe Master Profesional, 3 programe Master i Shkencave dhe 1 program doktorate (**doktoratura është e pezulluar**).

Programi i studimit në ciklin e parë të studimeve **Bachelor në "Histori-Gjeografi"** është hapur me VKM Nr. 352, datë 12.05.2010, me 180 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatje 3 vite akademike. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti *Histori- Gjeografisë*, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë. Programi është i regjistruar në QSHA e urdhër nr.323, datë 05.06.2017.

Numri total i studentëve për vitin akademik 2020-2021 ka qenë 29 studentë.

Ky program studimi i ciklit të parë bachelor, është në proces akreditimi për herë të parë.



## Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit për herë të parë të programit të studimit të ciklit të parë të studimit Bachelor në "Histori-Gjeografi", i ofruar nga departamenti i Historisë-Gjeografisë, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, i Universitetit "Fan.S.Noli" në Korçë (UK). Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve të ciklit të parë për Bachelorin, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet, konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive.

Vlerësimi i jashtëm bazuar tek standardet e cilësisë për këtë program studimi është fokusuar në 6 fusha vlerësimi:

1. Ofrimi i programit të studimit;
2. Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programit të studimit;
3. Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat;
4. Burimet;
5. Studentët dhe mbështetja e tyre;
6. Sigurimi i cilësisë në programin e studimit.

Në manualin e vlerësimit të BA/ASCAL, shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

Standardet nuk përmbushen;

- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Procesi i vlerësimit është bazuar në Manualin e Vlerësimit, i miratuar nga Bordi i Akreditimit (BA) dhe në përputhje me afatet e përcaktuara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) sipas të cilave procesi i vlerësimit zgjat 109 ditë nga data 23.07.2021 deri në 2.2.2022.

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.

I gjithë dokumentacioni i referuar, pasqyrohet në fund të këtij raporti dhe është i renditur sipas listës numerike të paraqitur në këtë aneks.

Procesi i vlerësimit është koordinuar nga koordinatori teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS dhe gjatë vizitës në institucion.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga: **Prof. Asoc.Dr.Nevila CINA, Prof.Asoc.Dr. Çlirim DURO**. Koordinatore teknike e ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Arjana Alija.


Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV).
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.
- Vizita në UK u zhvillua në datat 08 dhe 09 Nëntor 2021. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Gjatë vizitës në Institucion, vlerësuesit e jashtëm kërkuan disa materiale shtesë që koordinatori institucional i UK, me anë të sistemit AMS, i vendosi në dispozicion dhe që u përdorën nga GVJ gjatë hartimit të raportit.

- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.


Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, pa-anshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e UK. GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion.

*Universiteti "Fan S. Noli", Korçë është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 16.03.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 4/27 Prot, datë 16.03.2022. Universiteti "Fan S. Noli", përcjell në ASCAL, me anë të shkresës me Nr.505/1 Prot, datë 28.03.2022, "Kthim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm", ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga ekspertët e jashtëm. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.*



**Për Programin e studimit Bachelor në "Histori – Gjeografi" ofruar nga Universiteti "Fan S. Noli" Korçë.**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "Fan S. Noli", Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Histori- Gjeografisë (Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Histori - Gjeografi
4	VKM i licencimit:	VKM Nr. 352, datë 12.05.2010.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Regjistrimi i formës së diplomës:	QSHA Nr. 323, datë 05.06.2017
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10 PAE/3 PAK
18	Numri i studentëve:	29 studentë (cikël i plotë studimesh)





## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Histori -Gjeografi”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi I.1</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti “Fan.S.Noli” Korçë (UK) është një institucion publik i arsimit të lartë, hapur me VKM-në Nr.5, datë 07.01.1992 dhe akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit (BA) Nr.65, datë 21.09.2017, për një afat 5 vjeçar, deri më 30/09/2022.  Programet që ofron, nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe janë në përputhje me profilin e institucionit [Statuti UK, <b>Plani strategjik i njësisë bazë 2019-2023</b> ]. Bazuar në statutin dhe rregulloren e IAL [Statuti, <b>rregullore e përgjithshme UK</b> ], programet e ofruara nga UK synojnë përgatitjen e profesionistëve në fusha të ndryshme dhe janë në përputhje me qëllimin dhe objektivat e UK [ <b>Statuti i UK, pjesa qëllimet</b> ]. UK ka fokusuar veprimtarinë e tij në katër drejtime kryesore, atë të shkencave humane, shkencave ekonomike, shkencave natyrore dhe shkencave bujqësore, në këtë kuadër edhe programet janë në këto drejtime studimi. Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimeve të drejtuesve të UK-së dhe të Fakultetit të Edukimit të Filologjisë, programet e studimit të ofruara nga kjo njësi kryesore bazohen në studime të kryera nga institucioni lidhur me nevojat që ka sidomos rajoni, por edhe më gjerë [Evidenca 3.12, ]			
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.				
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.				
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Institucioni në vazhden e politikave të tij, por edhe te detyrimeve që ligji 80/2015 ka hartuar një plan te strategjise së zhvillimi për vitet 2016-2020 dhe ka hartuar nje draft plan të ri strategjik të zhvillimit, i cili nuk është miratuar në Senatën Akademik [Shtojca 1.3 <b>Plani strategjik i zhvillimit 2016-2020, Shtojca 1.3.1 Draft- Plani strategjik i zhvillimit</b> ] . Departamenti i <i>histori- gjeografisë</i> ka një strategji të vecantë për zhvillimin e njesisë baze [ <b>shtojca 2.4, Plani strategjik për zhvillimin e departamentit të Histori-Gjeografi</b> ].
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në	



përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	GVJ-ja konstaton se programi i studimit është në përputhje me planin e strategjik të zhvillimit strategjik në rang institucionial .			
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	Njëkohësisht GVJ-ja sugjeron miratimin në Senatit Akademik sa më shpejtë që të jetë e mundur, planin e ri të zhvillimit strategjik. Statuti i UK dhe rregullorja e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë [Shtojca 2.2] përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tyre; emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit bachelor në “histori –gjeografi” është në përputhje me fushat e deklaruara akademike të Universitetit të Korçës dhe Njësisë Kryesore dhe të vetë departamentit të Histori-gjeografise. [Shtojca 4.13-Fushat e studimit në njësinë bazë]. GVJ vëren se edhe në draft-strategjinë e re, institucioni ka të përcaktuara drejtimet strategjike të zhvillimit të programeve dhe fushave të studimit dhe kërkimit të cilat të jenë në përputhje me fushën e veprimtarisë së UK.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Programi i studimit i ciklit të parë Bachelor në “Histori-Gjeografi” ka dy objektiva të përcaktuara qartë në të cilat përfshihen: (a) dijet b) aftësitë e kompetencat profesionale dhe analitike Objektiva që në fund të programit duhet të fitojnë studentët.  Bazuar në këto objektiva, programi synon : - Të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme për formimin teorik dhe praktik - Të aftësojë studentët me kompetencat komunikuese, qytetare, dixhitale - Të kultivojë shprehitë shkencore, hulumtuese, kërkimore, analizuese - Të aftësojë studentët t'u përshtatet ndryshimeve në tregun e punës e të jenë konkurrues në të.  Bazuar mbi këto objektiva, programi të përgatisë profesionistë të shkencave të Historisë dhe Gjeografisë, të cilët të jenë të aftë profesionalisht të punojnë në sektorin publik dhe në atë privat [shtojca 2.3, rregullore e programit të studimit], kryesisht në mësuesi, por edhe në parqe arkeologjike, në qendra muzeale, në guida turistike, etj. Nga analiza e dokumentacionit, ne si ekspertë të jashtëm, nuk evidentuam raste konkrete studimi të tregut të punës që kanë orientuar hapjen dhe zhvillimin e programeve në tërësi nga kjo njësi kryesore apo për këtë program studimi në veçanti. Ndonëse në strategjinë e zhvillimit 2016-20
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	
<b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive,	

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

shkathësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.

20, është theksuar domosdoshmëria e hartimit të kurrikulave të përshtashme bazuar në sfidat e ekonomisë së tregut jo vetëm kombëtare por edhe ato ndërkombëtare .

*Nga ana tjetër, referuar edhe planit për zhvillimin strategjik të departamentit Histori-Gjeografisë,, në të cilin parashikohet që për zhvillimin e programeve të reja të studimit (nga ky departament) ato duhet të jenë në të njëjtën linjë me zhvillimet social-ekonomike te vendit, apo politikat rajonale të Qarkut të Korçës.*

Nga vizita në institucion, GVJ identifikoi se personeli akademik dhe drejtuesit, në mënyra të ndryshme, marrin informacione për nevojat e tregut të punës në rajonin e Korçës dhe i reflektojnë ato në përmbajtje të programit. Një e dhënë me shumë interes për këtë standard na u dha në disa takime por edhe e pasqyruar në RVB [**kriteri 2 Standardi I3**] në të cilën shpalosen të dhëna mbi studime në rang institucional nga Qendra e Karrierës dhe Alumni në të cilin ne shohim përpjekje të Institucionit për ta institucionalizuar këtë proces. Në këto studime objektivi ka qenë gjurmimi i ecurisë së studentëve në tregun e punës.

**GVJ rekomandon që departamenti Histori-Gjeografisë njësi bazë e FEF-së, njëkohësisht si struktura që ligji 80/2015 i jep të drejtën e përgjegjësisë së programeve të studimit (ndryshe nga ligji i vjetër që ja jepte këtë të drejtë Fakultetit) të kryejë një studim të përgjithshëm mbi nevojat e tregut të punës në lidhje me programet që ajo ofron (ku të përfshihet dhe programi Bsc Histori-Gjeografi).** Të dhënat e mbledhura nga burime të ndryshme, përfshirë edhe studentët e diplomuar, të analizohen dhe të hartohet një dokument analitik me propozime konkrete në kuadër të përmirësimit të programit të studimit (fokusi jonë është Bsc. Histori-Gjeografi).

Programi i studimit Bsc. Histori-Gjeografi është i organizuar në përputhje me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", e për këtë arsye objektivat formuese, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, që matin rezultatet e pritshme të të nxënit, që garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathësive e kompetencave në përputhje me nevojat e tregut e që mundësojnë punësimin e shpejtë të studentëve, janë pasqyruar në raport me detyrimet e VKM-së më sipër.

Programi i studimit i krijon mundësi studentit (bazuar në ndarjen që VKM-ja imponon) të marrë njohuri në lëndë bazë të grupit A, në lëndë karakterizuese të grupit B, në lëndë ndërdisiplinore/integruese të grupit C dhe në lëndë plotësuese të grupit D. Detyrimet përmbyllëse realizohen me temë dipome e cila i përket grupit E (në standardet më poshtë do të japim të dhëna më specifike për secilin nga grupet e përmendura më lart).

Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

**Standardi I.4**

**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Universiteti “Fan.S.Noli”, Korçë (UK) është një institucion publik i arsimit të lartë, hapur me VKM-në Nr.5, datë 07.01.1992 dhe akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit (BA) Nr.65, datë 21.09.2017, për një afat 5 vjeçar, deri më 30/09/2022.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bsc. në “Histori-Gjeografi” e ka filluar veprimtarinë e tij para 12 vitesh, çka tregon se tashmë institucioni ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukturore që disponon.</p> <p>Departamenti i Histori-Gjeografisë, si përgjegjës për programin e studimit Histori-Gjeografi, ka në përbërjen e tij 9 personel akademik efektiv të gjithë me gradën shkencore doktor, 3 personel akademik të ftuar (1 me titullin Prof. Dr, 1 me gradën Doktor dhe 1 Msc) dhe 1 personel ndihmës-akademik. Në këtë departament jep mësim dhe një personel akademik më kohë të plote i Universitetit [ <b>shtojca 2.9. shtojca 4 tabela 1</b>].</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit bachelor në histori – gjeografi është program dy disiplinor. Kjo është reflektuar dhe në përbërjen e stafit akademik prej të cilëve 5 pedagogë (4 efektiv dhe 1 i ftuar) janë të fushës së gjeografisë dhe 6 pedagogë (5 efektiv dhe 1 i ftuar) janë të fushës së historisë [ <b>shtojca 2.9. shtojca 4 tabela 1</b>].</p> <p>Programi i studimit që është në proces akreditimi dhe që ofrohet nga departamenti i Histori-Gjeografisë është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– <b>Bachelor në “Histori-Gjeografi”;</b></li> </ul> <p>Profili i programeve dhe fusha e përgjithshme dhe specifike e tyre përputhet me atë të njësisë kryesore që janë shkencë humane (<i>kjo bazuar dhe në ndarjen sipas manualit të FRASCATI</i>).</p> <p>Programi i studimit ofrohet nga departamenti i Historisë-Gjeografisë, fusha e veprimtarisë të së cilit përputhet me atë të programit të studimit. Departamenti ka bërë një punë paraprake për të bërë të mundur kodifikimin e lëndëve të programit të studimit Histori-Gjeografi, por <i>kodifikimi i programit të studimit ende nuk është kryer sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane pasi nuk është finalizuar akti nënligjor i cili udhëzon institucionet se si duhet kryer ky proces</i> [ <b>Ligji i arsimit të lartë 80/2015, neni 86</b>].</p> <p>Në takimet në Institucion u shpreh dhe shqetësimi që akoma nuk është zbatuar ligji i arsimit të lartë neni 86 pika 2, e cila flet “<i>për programet e studimit, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind</i>”, kjo për arsye mobiliteti brenda vendit, por edhe me gjerë.</p> <p>Niveli i njohurive që ofron programi i studimit Histori-Gjeografi, përkon me atë të nivelit 6 të Kornizës Shtetërore të Kualifikimit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi I.5**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Universiteti “Fan.S.Noli” Korçë (UK) është një institucion publik relativisht me një jetë prej 50 vitesh dhe kjo përbën një përvojë të konsidueshme në ndarjen e detyrave për mbarëvajtjen e programeve dhe të programit që kemi nën akreditim.</p> <p>Nga takimet me drejtuesit, na u vu në dukje se Institucioni ka evoluar dhe është përmirësuar në këtë drejtim, sidomos pas përvojës shume të mirë në Akreditimin Institucional, por dhe në akreditimet e programeve që sapo kanë filluar. Në takimet në institucion na u theksua edhe ndihma e madhe që i ka dhënë ASCAL në shumë nga problematikat që kanë hasur në këtë drejtim apo dhe në të tjera <b>[takimi me Koordinatorin Institucionale të UK]</b>.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Sipas dokumentacionit që GVJ konsultoi, RVB-së dhe takimeve në institucion, vumë re se në ndarjen e detyrave në mbarëvajtjen e programit, Institucioni është mbështetur në Statutin dhe rregulloren e përgjithshme të UK, në rregulloren e FEF dhe në rregulloren e Njesisë bazë.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Sikundër u theksua edhe gjatë vizitës në institucion nga drejtuesit, bashkëpunimi dhe koordinimi brenda institucionit zhvillohet në normalitet. Disa anëtarë të personelit akademik mbulojnë pozicione të ndryshme në strukturën e institucionit ose në komisione të ngritura për tematika të ndryshme.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Institucioni (UK) në funksion të programeve të tij të studimit ka bashkëpunime me disa Universitete brenda dhe jashtë vendit. Në funksion të programit të studimit Histori-Gjeografi, për të realizuar objektivat e këtij programi, në RVB ashtu dhe dokumentacionin e paraqitur, ka pak marrëveshje si brenda ashtu dhe jashtë vendit . Në takime të zhvilluara dhe nga shqyrtimi i RVB-së, shohim se është vendosja e marrëdhënieve me institucione të ndryshme të arsimit të lartë brenda, institucionet në rajonin e Korçës (sidomos DAR, parqet arkeologjike, muzetë, ADZM, etj.) <b>[Shtojca 2.10, marreveshje bashkëpunimi ]</b>. <b>[RVB standardi 1.5, kriteri 4 fq 10].</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p><b>Gjithsesi, ne si GVJ, mendojmë se në funksion të këtij programi, të shtohen numri i marrëveshjeve sëpari brenda vendit dhe më pas edhe me institucionet rajonale dhe me gjerë.</b></p> <p>Raporte analitike specifike në funksion të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, njësia nuk harton, por keto analiza jepen në kuadrin e hartimit të raportit vjetor të UK ( Ligji 80/2015, neni 32) .</p> <p><i>GVJ mirëkupton vështirësitë që has institucioni në bashkëpunime specifike për programin Histori-Gjeografi, por gjithashtu rekomandon që të gjitha veprimtaritë që kryhen (aq sa janë derri tani, por që në të ardhmen mund të shtohen) në kuadër të realizimit të proceseve akademikemike dhe administrative në funksion të programit të studimit, të ruhen, administrohen, analizohen dhe raportohen në përputhje me aktet e brendshme të miratuara nga ana e institucionit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Histori Gjeografi ” është hapur për herë të parë në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 352, datë 12.05.2010. Programi i studimit ofrohet nga departamenti i Historisë-Gjeografisë, FEF, i referohet nivelit të 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ( <i>e thënë edhe më lart</i> ) dhe organizohet në 180 ECTS. Programi është me kohë të plotë dhe realizohet në 3 vite akademike të ndarë në 6 semestra, me nga 15 javë secili [Shtojca 3.24] të cilat ndahen në lëndë/module bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 dhe VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” e ndryshuar dhe rregulloren e programit të studimit [Shtojca 2.5 rregullorja e programit të studimit ].
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.	Kurrikula është e orientuar nga kërkesat e tregut të punës dhe është ndërtuar nga një numër i mjaftueshëm disiplinash mësimore të grupuara në module bazë, karakterizuese, integruese, etj. Kurrikula ofron një formim bazë të ekuilibruar duke mundësuar kompetenca të shumëfishta për t’iu përshtatur profileve të ndryshme të punës (histori gjeografi etj.) Megjithatë, do të ishte e dobishme që lista e disiplinave me zgjedhje të studentit (C) të pasurohej. Në gjendjen aktuale mundësitë për përzgjedhje janë të kufizuara.
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Programi i studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi”, përmban një informacion të plotë në fushën e Historisë-Gjeografisë, por edhe të didaktikës. Ky informacion i shërben studentit për marrjen e njohurive në fushat specifike dhe të specializuara që ky program i ciklit të parë të studimeve ofron si dhe në përfitim të aftësive profesionale dhe kompetencave për ti shërbyer më mirë tregut të punës.
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit reflekton nevojat që ka tregu dhe ka objektiva të përcaktuara në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit.
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Me njohuritë e fituara në këtë program studimi, studentët kanë mundësi të përshtaten me kërkesat e tregut të punës dhe për të zgjeruar njohuritë e tyre profesionale në studime të mëtejshme në ciklet pasardhëse.
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të	Programi i studimit Histori-Gjeografi është i organizuar me kohë të plotë në tre vite akademike të ndarë në 6 semestra në total 180 ECTS. Këto kredite ndahen në 2193 orë mësimore në auditor ( 1097 leksione +1096 seminare ) dhe 2307 orë jashtë auditorit [Shtojca, 2.7 plani mësimor ].

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


<p>përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Vepimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike të cilat në të gjashtë semestrat janë organizuar në leksione, seminare, praktikë profesionale si dhe orët jashtë auditorit. Frekuentimi i orëve në auditor është i detyrueshëm për studentin në masën 75% <b>[Shtojca 2.5 rregullorja e programit të studimit]</b>.</p> <p>Lëndët e programit realizohen sipas orarit mësimor të miratuar nga dekani i Fakultetit, shpallur në ëbsite-in e Institucionit si dhe në ambientet e njësisë kryesore. <i>GVJ konstaton se orari është miratuar nga drejtues i fakultetit ashtu siç parashikohet në rregulloren përkatëse dhe e quan një praktikë të mirë dhe të vlerësuar edhe nga studentët .</i></p> <p>Shpërndarja e ngarkesës mësimore është bazuar në ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, neni 59 pika 8 dhe në udhëzimet e MASR Nr.29, datë 10.09.2018. Gjatë vizitës në institucion GVJ shqyrtoi dokumentin lidhur me shpërndarjen e ngarkesës mësimore për vitin akademik 2018-2019, 2019-2020 dhe 2020-2021 të miratuara me vendim të Senatit Akademik dhe vlerësoi ndarjen sipas rregullores në fuqi. Ngarkesa mësimore përcaktohet në orët mësimore në auditor dhe përfshirja në aktivitete të tjera në dobi të njësisë.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga DH-GJ, për këtë program studimi, GVJ konstatoi se:</p> <p>Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 59 pika 3, <i>titullari i lëndës duhet të jetë i kategorisë Profesor. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni në të gjitha lëndët e zhvilluara në këtë program me pak përjashtime mungon titullari i lëndës me këtë kategori.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi II.2</b></p>	
<p><b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Departamenti i Historisë-Gjeografisë në FEF, si përgjegjës për programin e studimit Bsc. “Histori-Gjeografi”, i përmbush detyrimet ligjore për akreditimin e programit, pasi ka në përbërjen e tij 9+1 personel akademik efektiv (PAE) dhe 3 personel akademik me kontratë (PAK). Në total, departamenti ka në përbërjen e tij 14 personel akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në departament (RVB-DVV) raporti personel akademik efektiv me personelin akademik me kontratë është 9 me 3 ose 3/1.</p> <p>Programi i studimit histori – gjeografi është program dy disiplinor. Kjo është reflektuar dhe në përbërjen e personelit akademik prej të cilëve 5 pedagogë (4 efektiv dhe 1 i ftuar) janë të fushës së gjeografisë dhe 6 pedagogë (5 efektiv dhe 1 i ftuar) janë të fushës së historisë. Personel akademik efektivë mbulojnë 89.4% (159 kredite) të ngarkesës së programit mësimor, Personel akademik e ftuar 10 % (18 kredite) të</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>ngarkesës mësimore dhe 1.6% (3 kredite) mbulohet nga 1 pedagog efektiv i UK.</p> <p><i>GVJ konstaton se bazuar në ligjin e arsimit të lartë 80/2015, në të cilin është përcaktuar se në procesin e mësimdhënies duhet të përfshihet personel akademik mik me një formim më të lartë se cikli paraardhës, stafi mësimdhënës i plotëson kriteret ligjore.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Nga verifikimet për stafin e institucionit që ushtrojnë funksione drejtuese konstatohet se edhe stafi drejtues (dekan dhe përgjegjës departamenti) i plotëson kriteret e përcaktuara në ligjin e arsimit të lartë 80/2015.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Grupi i vlerësimit u njoh me stafin ndihmës administrativ dhe konstatoi se ky staf i përmbush kriteret e kualifikimit dhe profesionalizmit që kërkohet në këto pozicione pune.</p> <p>Programi i studimit ka një koordinator të studentëve që luan rolin dhe të koordinorit të programit të studimit, i cili është staf akademik me kohë të plotë që ka formimin dhe kualifikimin e duhur për të kryer këtë funksion.</p> <p>Koordinatori i programit përgjigjet për realizimin e programit mësimor dhe praktikës profesionale dhe marrëdhënive me studentët. Detyrat dhe mënyra e raportimit janë të dokumentuara në rregulloren e funksionimit të programit <b>[rregullorja e FEF, rregullorja e Departamentit]</b>.</p> <p>Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë përmbush detyrimet ligjore përse i përket strukturës akademike, kualifikimeve të stafit, ngarkesës mësimore në auditor të detyrueshme sipas kategorive përkatëse të personelit akademik.</p> <p>Sipas <b>[Shtojca 2.2]</b> rezulton që kjo njësi përmbush të gjithë detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore duke ushtruar kompetenca të plota mbi mbarëvajtjen e mësimit dhe kërkimit, siç përcaktohet edhe në rregulloren e studimeve të FEF dhe të programit Bsc në “Histori-Gjeografi” <b>[shtojca 4, tabela 1]</b>.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.3</b>  <b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>Grupi i ekspertëve të jashtëm, pas shqyrtimit të Dosjes së Vetëvlerësimit të programit të studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi”, takimeve gjatë vizitës në UK dhe dokumentave shtesë pas vizitës në institucion, thekson se DHGJ, disponon informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në</p>	<p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, programi i studimit është organizuar sipas Ligjittë Arsimit të Lartë 80/2015, VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga</p>



përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	<i>institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar dhe rregulloresë programit të studimit [shtojca 2.5].</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	GVJ, pas shqyrtimit të dosjes së vetëvlerësimit, RVB-së dhe dokumentacionit të paraqitur nga DHGJ gjatë vizitës në institucion, konstatoi se programi i studimit është i organizuar në lëndë, aktivitete formuese dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit Evropian të transferimit të kreditive (ECTS ) të cilat zhvillohen në tre vite akademike të ndara në 6 semestra.			
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	GVJ gjithashtu, konstaton se gjendet informacioni i nevojshëm lidhur me planin mësimor, ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit, mënyrën e vlerësimit të dijeve, mënyrën e frekuentimit të programit, orarin e zhvillimit të programit, etj. <b>[Plani mësimor, rregullorja e programit, rregullorja e Departamentit, etj].</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizitës në institucion, konstaton se institucioni ka një informacion për studenttë lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit <b>[rregullorja e FEF, rregullorja e departamentit, rregullorja e programit të studimit ]</b> .			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikatat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Në lidhje me kriteret përzgjedhëse, programi i studimit <b>nuk aplikon</b> kriteret të veçanta, përveç atyre që imponon VKM-ja e çdo viti nga ana e Qeverisë. <b><i>Në takime na u ngrit shqetësimi, se rritja çdo vit e notës mesatare në programin Histori-Gjeografi ( i trajtuar si program mësuesie), ka bërë që në këtë program studimi, të këtë një ulje drastike të numrit të studentëve. Shqetësimi qëndonte që kjo rritje e notës mesatare çdo vit, nuk është përkthyer automatikisht në rritje të cilësisë.</i></b> Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Histori-Gjeografi”, ofruar nga departamenti i Historisë-Gjeografisë, përmban informacion lidhur me syllabuset që zhvillon programi, ndarjen në leksione, seminare, orët brenda dhe jashtë auditorit.			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Syllabuset e lëndëve janë të organizura dhe përmbajnë informacionin e nevojshëm, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi <b>[VKM Nr. 879, datë 12.18.2019].</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi i studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi”, bazuar në ligjin e arsimit të lartë 80/2015, VKM Nr. 879, datë 12.18.2019 dhe në rregulloren përkatëse të programit të studimit është organizuar në



Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>leksione, seminare dhe praktikë [<b>plani mësimor për tre vitet e fundit, shtojca 2.7</b>]. Ndarja në kategori (A, B, C, D dhe në E) është në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, <i>edhe ngarkesa në kredite (në %) përputhet plotësisht me legjislacionin në fuqi dhe duhet të ndryshojë [shtojca 2.7]</i>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimi profesional.</p>	<p><i>Disiplinat e formimit bazë</i>, të cilat synojnë pajisjen e studentëve me njohuri të përshtatshme teorike dhe shprehje praktike për krijimin e bagazhit të duhur shkencor që përcaktojnë formimin e përgjithshëm. Ato zënë 20% të krediteve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p><i>Disiplinat e formimit karakterizues</i>, që synojnë sigurimin e një konteksti akademik për diskutimin e çështjeve që lidhen me nëndisiplina / nënfusha të shkencës historike e gjeografike, me synim, zhvillimin e perspektivës teorike të studentëve edhe edukimin e kompetencave analitike për secilën lëndë. Ato plotësojnë kuadrin e njohurive teorike dhe aftësive praktike të studentëve dhe përbëjnë 50% të krediteve.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p><i>Grupi i lëndëve ndërdisiplinore dhe integruese</i> të ngjashme dhe/ose plotësuese me disiplinat karakterizuese apo profilin e programit, ato zënë 12.2% të krediteve.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p><i>Lëndë plotësuese</i>, synojnë të pajisin studentët me njohuri më të gjera rreth lidhjes së historisë e gjeografisë me disiplina të tjera në fushën e shoqërisë dhe mjedisit si dhe gjuhës – komunikimit dhe teknologjisë të fokusuara në përfundimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës. Lëndët plotësuese përbëjnë 12.8% të krediteve</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p><i>Detyrime përmbyllëse</i>, (5% të krediteve) lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar. Shpërndarja e ngarkesës mësimore në program përcaktohet nga vetë Departamenti dhe ishte zbatuar ndarja sipas të Udhëzimit të MASR për ngarkesën mësimore Nr.29, datë 10.09.2018, i ndryshuar. Me detaje, ngarkesën mësimore e analizojmë tek standardi II.5.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi Bachelor në Histori-Gjeografi, është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre teorike në fusha të Historisë dhe Gjeografisë, të cilat të jenë të lidhura me kërkesat e tregut të punës, e në veçanti në rajonin e Korçës [<b>rregullorja e programit të studimit</b>].</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Organizimi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore orë/kredite ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive të nevojshme profesionale. Studentët në këtë program studimi në auditor marrin: 1. 1097 orë leksione; 2. 1096 orë seminare; <b>Në total studentët përfitojnë 22193 orë mësimore [shtojca 2.7].</b> Duke parë me shumë kujdes planin mësimor dhe silabuset, shohim se përmbajtja e programit të studimit është hartuar në mënyrë të tillë që në lëndët historike të respektohet kronologjia e etapave historike; dmth: gjatë vitit të parë studentët të marrin pjesën më të madhe të lëndëve që</p>



	<p>përmbajnë njohuri të formimit të përgjithshëm, të kombinuara me lëndë të formimit karakterizues dhe ato ndërdisiplinore. Në vitin e dytë dhe të tretë, ata thellojnë njohuritë me lëndë të natyrës karakterizuese të ndërthurura me kategoritë e tjera. Nëpërmjet kësaj shpërndarjeje studentëve ju jepet mundësia të zgjerojnë në mënyrë graduale njohuritë e përgjithshme, duke ndërthurur me njohuri karakterizuese të programit që merren gradualisht, të kombinuara me kategoritë e tjera. Shpërndarja e lëndëve në kurrikul është menduar në këtë mënyrë që, nga ana tjetër, të lehtësojë arrijten e objektivave formuese të programit të studimit.</p> <p>Përmbajta e programit i shërben studentëve për thellimin e njohurive dhe krijimin e kushteve të duhura për një kompetencë të nevojshme në të ardhmen, kur ata të ushtrojnë profesionine tyre (<i>pas masterit</i>). Ky program u krijon mundësi të thellohen në ciklin e dytë, Master Profesional ose Master i Shkencave në fusha si Histori dhe Gjeografi.</p> <p><i>GVJ mendon se në kushtet e një tregu shumë të vogël që ka vendi ynë kjo mundësi është një pikë e fortë për këtë program. Kjo gjë u theksua edhe në takimet që patëm më personelin akademik, por sidomos në takimin me studentët [takimi me studentët].</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Personeli akademik efektiv (PAE) dhe ai me kontratë (PAK) në programin e studimit Histori-Gjeografi përmbush kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga UK, listën e stafit akademik, planin mësimor të lidhur me stafin akademik, syllabuset e programit të studimit GVJ, shprehet si më poshtë: Për vitin akademik <b>2020-2021</b> , në këtë program studimi janë angazhuar: 10 pedagogë efektivë dhe 3 pedagogë me kontratë. <b>Në aspektin numerik në % raporti për këtë vit akademik është 77 % PAE / 23 % PAK.</b> Në të gjitha vitet e mësipërme, pranë stafit akademik është si mbështetje dhe një personel si staf ndihmës akademik me drejtim administrativ.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Në rregulloren e programit të studimit paraqiten në mënyrë të plotë kriteret dhe procedurat e ndarjes së ngarkesës mësimore brenda dhe jashtë auditorit, disiplinat e formimit në këtë program, personelin akademik përgjegjës dhe infrastrukturën në dispozicion të këtij programi <b>[shtojca 2.5, rregullorja e programit të studimit]</b> . Personeli akademik mbulon lëndë mësimore në fushën e tyre të kualifikimit, madje bëhen
<b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	përpjekje për të patur parasysh në këtë ndarje edhe fushat e tyre të kërkimit të thelluar shkencor. Personeli akademik efektivë mbulon 89.4% (159 kredite) të ngarkesës së programit mësimor, Personel akademik e ftuar 10 % (18 kredite) të ngarkesës mësimore dhe 1.6% (3 kredite) mbulohet nga 1 personel akademik nga UK. Personeli akademik i Departamentit mbulon lëndët/modulet mësimore të historisë dhe gjeografisë dhe në programe të tjera studimi të UK [RVB, fq.9]. Referuar të dhënave të paraqitura nga UK, GVJ ka mundur të llogarisë <b>ngarkesën në orë dhe % që mbulohet nga PAE dhe PAK</b> dhe konstaton se <b>raporti është në përputhje të plotë me Ligjin 80/2015 dhe Kodin e Cilësisë</b> . Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, GVJ konstaton se, <b>në disa raste përjashtimore, në disa prej lëndëve të zhvilluara në këtë program studimi, titullari i lëndës nuk i përket kategorisë “Profesor”</b> , sikurse kërkohet në ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 59, pika 3. Ngarkesa mësimore e studentëve gjatë një jave varion rreth 20-25 orë mësimore në javë. UK, siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik mësimor me drejtimadministrativ të përshtatshëm për mirëmbajtjen e mjediseve mësimore, gjëe cila na u tha në takimet gjatë vizitës por edhe nga studentët.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.				
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b> <b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Institucioni ka hartuar një udhëzues në formatin e një rregullorje: “Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore”, duke mundur rregullimin e kuadrit të përgjithshëm institucional për mësimdhënien dhe të nxëniet. Ato detajohen edhe në Rregulloren e Programit mësimor të programit të studimit që kemi nën vlerësim dhe në rregulloren e njësisë bazë të FEF [Shtojca 1.2, shtojca 2.2, Shtojca 2.5].


Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: www.ascal.al

<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Po në këtë drejtim, GVJ thekson se dhe në planin strategjik të UK 2016-2020, janë parashikuar disa mënyra bashkëkohore për të zhvilluar metoda sa më efikase dhe në këtë drejtim [shtojca 1.3, plani strategjik, edukimi fq 21 ].</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Duke pasur parasysh natyrën e këtij programi studimi, metodat e përdorura në funksion të mësimdhënies dhe të nxënies, rezultojnë të zhvillohen në trajtën e leksioneve dhe seminareve në auditor duke synuar përvetësimin e njohurive nga studentët si dhe nxitjen e komunikimit mes studentëve dhe pedagogëve si dhe në trajtën e kërkimit të aplikuar në terren duke synuar gërshetimin e teorisë me aftësitë praktike.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Në Universitetin e Korçës në nivel qendror është ngritur dhe funksionon struktura e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Struktura kryesore përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel Universiteti është Drejtoria e Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional ( DKVI)</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Njësia për Sigurimin e Cilësisë në nivel njësie kryesore [Shtojca 3.4 – Vendimi për ngritjen e DKVI], shërben si mekanizëm i rëndësishëm monitorimi dhe vlerësimi në mënyrë periodike i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe atij ndihmës akademik.</p> <p>Kjo strukturë (DKVI) është përgjegjëse për të zhvilluar mekanizmat e monitorimit të vlerësorë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik në rang institucional.</p> <p>DKVI ka realizuar pyetësorët e studentit në rang institucional dhe më pas ka bërë analiza mbi këto raporte. Këto analiza kanë për qëllim matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, kjo e shoqëruar dhe me një analizë SËOT. Njësia realizon edhe një analizë krahasuese për pyetjet e njëjta dhe përgjigjet e studentëve në vite të ndryshme.</p> <p>Struktura përkatëse në punën e saj, harton dhe projektton një raport me propozime dhe rekomandime për përmirësimin e cilësisë dhe ja dërgon çdo Njësie Kryesore. Sipas procedurës së miratuar, njësia këto rekomandime i bën objekt të diskutimit me stafin e saj akademik. Pas analizës në Njësinë Kryesore, mendimet mbi këto problematika çohen në Rektorat dhe ai më pas dilet me nje plan masash [Shtojca 3.17 model analize ].</p> <p>Në këtë vlerësim nga ana e njësisë së cilësisë është dhe programi i studimit Bsc. Histori-Gjeografi me rekomandimet përkatëse.</p> <p><i>GVJ e vlerëson si një praktikë të mirë këtë procedurë, por do të rekomandonte që për planin e masave, të mund të ketë një konsultim paraprak edhe me studentë.</i></p> <p><i>Rekomandim i GVJ-së është bërja funksionale e njësisë të sigurimit të cilësisë, në rang fakulteti duke u mbështetur tek përvoja shumë e mirë e funksionimit të DKVI-së .</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>




<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra UKsit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në programin e studimit Bsc. Histori-Gjeografi, sipas dokumentacionit në DVV, RVB, por edhe në takimet që GVJ zhvilloi në institucion, konstaton se format e mësimdhënies që përdoren në procesin mësimor janë metodat standare si leksione, seminare, praktika në terren, detyrat e kursit dhe tema të diplomave. Format e lartpërmendura mbeten të hapura për përmirësime dhe pasurohen periodikisht me elementë të rinj. <b>[shtojca 2.5, rregullore e programit të studimit +silabuset ]</b>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Personeli akademik njih dhe respekton diversitetin e karaktereve dhe interesave individuale të studentëve dhe përshtat metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies me këto vecori. Raporti midis formave të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies ndryshon në varësi të natyrës së moduleve të programit, duke tentuar që në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve të rrisë kontaktin e drejtpërdrejtë të studentëve me objektet konkrete të profesionit të tyre të ardhshëm, nëpërmjet rritjes së peshës së praktikave mësimore dhe profesionale në raport me format e tjera të mësimdhënies/mësimnxënies. Personeli akademik, në këtë program studimi, por edhe për programet e tjera të DHGJ, përdor metoda alternative gjatë mësimdhënies si prezantime në poëerpoint, mënyra audiovizive, biseda interaktive, etj. <i>Në programin e studimit nuk kanë pasur studentë me aftësi ndryshe, por GVJ rekomandon që edhe për këtë kategori të paraqitet në rregullore mënyra se si do të veprohet .</i> Në takimet me stafin akademik na u bë me dije se ata i marrin parasysh kërkesat dhe sugjerimet e studentëve për zhvillimin më efektiv dhe cilësor të mësimin, leksioneve apo seminareve, për ti bërë ato më efektive dhe tërheqëse.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	UK, u siguron stafit akademik logjistikën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor duke bërë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit të tyre profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Gjatë vizitës në mjediset e institucionit rezultoi se infrastruktura dhe baza materiale në auditore dhe laboratore, në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve, lejon dhe mundëson aplikimin efektiv të metodave të shumëllojshme të mësimdhënies. Sallat e leksioneve seminareve janë të përshtatshme, të pajisura me videoprojektor, tabela për të shkruar, kanë sistem ngrohje, etj
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Ashtu siç u theksua edhe më lart, Institucioni me anë të strukturave të cilësisë, vlerëson në mënyre periodike stafin akademik, procesin e mësimdhënies duke përfshirë në këtë proces edhe studentët nëpërmjet plotësimit të pyetësorit të vlerësimit <b>[Statuti rregullorja e FEF]</b> .
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe	

diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Personeli akademik përdor projektorët për prezantime poërpoinit për dhënien e leksioneve dhe prezantimeve.			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkujojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Sipas rregullores, gjatë procesit mësimor dhe praktikës apo punimit të temës së diplomës, studentët asistohen nga Personel akademik e tyre si në ndërtimin e strukturës së diplomës, zgjedhjen e temës apo hartimin e saj duke gjetur tema të lidhura me problematika kryesore të Historisë apo Gjeografisë, sidomos në fushën e mësimdhënies. Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies është interaktiv dhe stimulon punën e pavarur të studentëve. Këtij qëllimi i shërben në mënyrë të vecantë rritja e peshës së detyrave dhe projekteve të kursit në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve. Puna për përgatitjen e detyrave dhe projekteve të kursit shtrihet në kohë për disa javë dhe kërkon angazhimin intensiv të studentëve jashtë orëve të mësimit. Si e tillë ajo inkurajon punën në grup të studentëve paralelisht me kontributet individuale të secilit prej tyre. Ndonëse punë e pavarur e studentëve përgatitja e detyrave dhe projekteve të kursit monitorohet e mbështetet nga personeli akademik gjatë të gjithë kohës së realizimit të tyre. <i>GVJ nuk identifikoi forma dhe metoda të tjera, (përveç platformave microsoft temas te zhvillira gjate pandemisë), të përdorimit të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve që ndërthuren me teknologjinë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



<b>Standardi III.3</b>	
<b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Programi i studimit Bsc. Histori-Gjeografi e zhvillon veprimtarinë e tij në ambientet që i përkasin Fakultetit Edukimit të Filologjisë të Universitetit të Korçës. [Shtojca 4, tabelle 16]. Në raportin e vetvlerësimit ashtu dhe ne vizitën në institucion për këtë program studimi janë gjithashtu të përfshira edhe laboratorit Gjeografisë në mjediset e Rektoratit, laboratorët TIK, Qendra e Formimit të Vazhduar, si dhe salla e konferencave. Hapësirat krijojnë mundësinë e shfrytëzimit të sipërfaqes sipas standrdeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi raporti nje student = 2.48 m <sup>2</sup> /student. [Shtojca 2.5, tabela 16]. Standadrdet shtetërore për sipërfaqen në dispozicion të zhvillimit të programit mësimor (m <sup>2</sup> /student) janë konfirmuar edhe nga auditime të realizuara nga MASR.
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Hapësirat në këtë njësi kryesore janë të mjaftueshme dhe të përmirësuara ndjeshëm këto vitet e fundit. Programi ka gjithsej 29 studentë në të treja vitet dhe ky numër u siguron atyre kushte të mira mësimdhënie
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	[Dokumenti i kërkuar nga GVJ, gjatë vizitës ne Institucion]. Nga
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>vizita në institucion vumë re se sallat ishin të pastra dhe të mirëmbajtura dhe të pajisura me ndriçimin e duhur.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve ekziston një infrastrukturë e konsoliduar IT, që ofron shërbime të shumta dhe cilësore (korrespondencë elektronike, kërkim dhe shfrytëzim online të materialeve didaktike dhe shkencore, informim on line të rezultateve të vlerësimit gjithëvjetor dhe përfundimtar, komunikim elektronik pedagog-student). Pjesë e rëndësishme e infrastrukturës IT, në shërbim të pedagogëve dhe studentëve është sistemi elektronik i vlerësimit gjithëvjetor dhe përfundimtar të studentëve (<a href="https://www.unikorke.esse3.ugov.rash.al">https://www.unikorke.esse3.ugov.rash.al</a>). Sistemi mundëson informimin në kohë reale të studentëve lidhur me rezultatet e tyre dhe rrit përgjegjshmërinë e pedagogëve për vlerësimin e studentëve dhe transparencën për të gjithë procesin. Në kushtet konkrete të ndërprerjes disa mujore të mësimin në auditor, realizimi i mësimin online është mundësuar nëpërmjet platformave të ndryshme. U përdorën gjerësisht gjatë vitit akademik 2019 – 2020 platformat Google Classroom, Edumeet dhe Moodle. Aktualisht UK punon me platformën Office 365 for Education dhe aplikimin e saj në mësidhënien online [shtojca 2.18 Manual për mësimin online].</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p><b>GVJ, rekomandon që universiteti të vendosi sa me shpejt në funksion faqen zyrtare te universitetit.</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të UKsit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Për të gjithë modulet e programit mësimor ekziston literatura bazë në gjuhën shqipe, përparitur nga pedagogët përkatës. Cilësia e literaturës bazë dhe përpuethshmëria e përmbajtjes së tyre me atë të programit të studimit garantohet nëpërmjet diskutimit dhe miratimit të përmbajtjes së teksteve mësimore në departament. Të mësuarit prej studentëve e lëndëve të formimit profesional mbështetet nga skripte ose tekste mësimore të stafit akademik të departamentit dhe homologëve të tyre në Universitetin të Tiranës.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Universiteti i Korçës dispon bibliotekën e vet, e cila vec të tjerave ka një fond prej librash me karakter human dhe social. Fondi i librave dominohet nga libri shqip dhe është bazuar thuajse tërësisht në dhurime. Ky fond përbëhet prej rreth 30.000 librash, rreth 12.000 tituj dhe 230 vende leximi. Biblioteka e FEF ka një fond prej 5644 titujsh, prej të cilave 1716 tituj janë literaturë primare për studentët e programit të studimit “Histori – Gjeografi . Sipas RVB-së faqe 25, rreth 60% e studnetëve të këtij programi janë anëtarë të bibliotekës së Fakultetit. Për shkak të pandemisë, UK ka shfrytëzuar qasjen në biblioteka digjitale, duke u ofruar punonjësve dhe studentëve të tij falas gamën e gjerë të librave në bibliotekat elektronike: U - Library, EBSCO, ProQuest etj.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Gajtë vizitës në ambientet e FEF, pamë që orari zyrtar i bibliotekës është 8:00 - 16:00, ky konstatim na u tha dhe gjatë takimit me studentët e programit nën akreditim.</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet UK ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Në lidhje me literaturën, e cila sipas rregullores është e përcaktuar në fund të çdo syllabusi, studenti gjen informacion lidhur me literaturën që mund të konsultojnë në gjuhën shqipe apo të huaj që i përgjigjet temave të programit mësimor.</p>






	<p><i>Nisur nga sa më sipër GVJ rekomandon; që UK duhet të rrisë mbështetjen financiare për pasurimin e Bibliotekës së UK dhe Bibliotekës sa Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë me literaturë në fushën e shkencave humane dhe ato sociale, sidomos në gjuhë të huaj.</i></p> <p>Në rregulloren e programit të studimit kemi të përcaktuar se temat e diplomës zgjidhen nga studentët në konsultim me personelin akademik te tyre në mënyrë që temat e tyre të jenë lidhur me problematikat aktuale të Historisë dhe Gjeografisë, kryesisht në fushën e mësimdhënies. Sipas rregullore, drejtuesit e temave miratohen nga departamenti, ndërsa mbrojtja bëhet e hapur dhe sipas procedurave të parashikura në rregullore [shtojca 2.14, manual për punimin e temës së diplomës]</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Nga raporti i mësipërm kur kemi folur për sigurimin e brendshëm të cilësisë kemi theksuar se njësia përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucional është DKSCCKSH [Shtojca 1.1, Statuti i UK, Shtojca 1.5, rregullorja e DKSC]. Brenda kësaj strukture funksionon sektori i kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë, pjesë përbërëse e të cilit është “Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”. Aktiviteti i këtyre strukturave rregullohet nga “<b>manuali i cilësisë</b>”.</p> <p>Kjo njësi ka miratuar procedurën e analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi dhe mbi bazë e saj, kryen aktivitetin në promovimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies [procedura dhe manuali miratimi i saj me Vendim Senati Nr.21, datë 08.05.2018].</p> <p>Në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies në takimet në institucion, na u theksua dhe përvoja shumë e mirë e fituar në kuadrin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve (sondazh i kryer nga ASCAL).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i historisë dhe i gjeografisë është përgjegjësi kryesor për cilësinë e mësimdhënies në programin e studimit bachelor në “histori-gjeografi”.</p> <p>Departamenti monitoron rregullisht procesin e mësimdhënies/mësimnxënies dhe atë të vlerësimit të studentëve dhe analizon situatën periodikisht [Shtojca 3.8-Analiza vjetore e njësisë bazë]. Departamenti i kushton rëndësi përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies/mësimnxënies edhe nëpërmjet nëpërmjet inkurajimit të aktivitetit shkencor të stafit të vet akademik dhe përfshirjes së studentëve në projekte kërkimi në fushën e histories dhe atë të gjeografisë [Shtojca 2.24-Angazhimi i stafit në projekte]. Kërkimi shkencor dhe aktiviteti botues i stafit akademik analizohen gjithashtu</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të</p>	

mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	periodikisht në analizat vjetore të departamentit <b>[Shtojca 3.8-Analiza vjetore e njësisë bazë]</b> . Performanca individuale vjetore e stafit akademik monitorohet e vlerësohet rregullisht nëpërmjet plotësimit të formularëve të hartuar për këtë qëllim <b>[Shtojca 3.8-Analiza vjetore e veprimtarisë mësimore e shkencore të njësisë bazë]</b> . Si stafi akademik, ashtu edhe ai mbështetës, i janë nënshtruar formave të shumëllojshme të trainimit të tyre personal.			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Nga vizita në nivel institucional, rezultojnë se cilësia e mësimdhënies promovohet dhe monitorohet nga Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, e cila është përgjegjëse për koordinimin e procedurave të vlerësimit të njësive akademike të brendshme dhe të jashtme. Këto struktura mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	<p>Personeli akademik dhe ndihmës akademik janë tërësisht përgjegjës dhe të angazhuar në programin e studimit. Vihet re një tendencë pozitive në lidhje me përmirësimin e mësimdhënies si dhe implementimin e metodave të reja.</p> <p>Të gjithë anëtarët e departamentit kanë grada shkencore <b>[Shtojca 2.9, Jetëshkrime të stafit akademik]</b> në fushat përkatëse të mësimdhënies dhe në takimet e zhvilluar në institucion na u tha se të disa nga stafi ishin aktualisht të përfshirë në procesin e plotësimit të dosjeve për tituj më të lartë akademikë.</p> <p>Në RVB por dhe nga dokumentacioni i shqyrtuar mund të themi se: DHGJ-ja, krijon hapësira dhe lehtëson procedurat në kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit, me anë të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Organizimin e veprimtarive shkencore që lidhen me shkencat e historisë, gjeografisë dhe mësimdhënies</li> <li>2. Koordinimin e informacionit për mundësi botimi apo thirrje në veprimtari shkencore ndërkombëtare.</li> <li>3. Angazhimin e stafit akademik në projekte institucionale, kombëtare e ndërkombëtare</li> <li>4. Hartimi dhe aplikimi i projekteve në nivel departamenti<sup>1</sup></li> <li>5. angazhimin e stafit akademik në botimin e artikujve dhe redaktimin e “Vjetarit “FEF”</li> </ol> <p>Ndërkohë, stafi akademik është autor i një sërë artikujsh në periodikë lokalë/vendas ose të botuar jashtë vendit <b>[shtojca 2.24 projekte të zbatuara nga departamenti, shtojca 3.8-Analiza vjetore e veprimtarisë mësimore e shkencore të njësisë bazë]</b></p> <p><i>GVJ thekson se duhet bërë një punë më e madhe në këtë drejtim dhe sugjerojmë se duhet në të ardhmen të ketë të paktën një aktivitet kërkimor shkencor një herë në vit në fushën e programit të studimit që po akreditohet.</i></p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			<b>X</b>	

<sup>1</sup> Shtojca 2.24 Projekte të zbatuara nga departamenti



<b>Standardi III.5</b>				
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Kriteret dhe mënyra e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve janë pasqyruar në mënyrë të detajuar në Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore të UK [Shtojca 1.2, Kreut VII - Procedurat e vlerësimit të studentëve, ], sipas përcaktimeve të Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore të Fakultetit të Edukimit dhe të Filologjisë. [Shtojca 2.2] dhe Rregulloren e brendshme të Departamentit të Historisë dhe Gjeografisë [shtojca 2.3]. Rregulloret përcaktojnë sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit dhe të kontrollit të dijeve, kushtet që duhet të plotësojnë studentët për të hyrë në provim, mënyrën e organizimit të provimeve, shpalljen e rezultateve dhe procedurën e ankimimit të studentëve në rast të pakënaqësive për rezultatet e provimit.</p> <p>Studentët informohen në detaje për të gjitha çështjet e mësipërme dhe sidomos për mënyrën e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive në fillim të çdo moduli mësimor. Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve ndahet në vlerësimin vazhduar (deri në 30%) të totalit të pikëve dhe atë përfundimtar dhe realizohet në formë të shumëllojshme përfshirë organizimin e seminareve, detyrave të ndërmjetme, ushtrimeve dhe punëve laboratorike, mbrojtjen e detyrave dhe projekteve të kursit, etj. Provimi përfundimtar zë deri në 70% të totalit të pikëve dhe realizohet me shkrim, me gojë, ose i kombinuar me shkrim dhe gojë.</p> <p>Studentët informohen nga titullari i lëndës/modulit me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore në fillim të çdo viti akademik apo lëndëve të veçanta të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve dhe rregulloren e funksionimit të FEF si dhe rregulloren e programit të studimit [plani mësimor, dosja e programit].</p> <p>Testimi i dijeve dhe aftësive profesionale bëhet me shkrim, gojë ose me temë diplome sipas rregulloreve të funksionimit të programit. Mënyra e procedura e vlerësimit, ju komunikohet studentëve në fillim të procesit mësimor [rregullore e programit të studimit].</p>			
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.				
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në formë dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Testimi i dijeve të studentëve në këtë program studimi, realizohet në dy sezone “Dimër”, “Verë” dhe në përfundim të programit mësimor. Sipas parashikimeve që janë në syllabuset e depozituara, ka dhe teste të

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>ndërmjetme. Ky testim në tre periudha kohore u pa nga GVJ dhe në kalendarin e provimeve të vitit akademik.</p> <p>Përcaktimi i raporteve mes vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar bëhet nga pedagogu/pedagogët në programin e modulit dhe ju bëhet e ditur studentëve me fillimin e modulit mësimor. Marrja e studentëve në provim bëhet nga komisioni i provimit që përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Çdo student ka llogarinë e tij elektronike, ku njihet me rezultatet e provimeve. Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuar të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Në përbërje të komisioneve janë minimalisht dy antarë. Cdo formë e mundshme e kopjimit, ose mashtrimit nga ana e studentit gjatë provimit ndëshkohet me përjashtimin e tij nga provimi dhe shpalljen ngelës për sezonin në fjalë <b>[Shtojca 2.2-Rregullore e njësisë kryesore FEF]</b>.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Studentët pohojnë se gjatë vlerësimit të vazhduar (30%), por dhe gjatë vlerësimit përfundimtar (me shkrim dhe me gojë) personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme bën sqarime të qarta në mënyrë që edhe vetë studenti të ndërgjegjësohet mbi arritjet momentale dhe të mund të përmirësohet në të ardhmen. Rezultatet e provimit hidhen në sistem nga komisioni i provimit brenda afateve të përcaktuara. Pas shpalljes së rezultateve studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të kundërshtojë rezultatin e marrë brenda dy ditëve (48 orë).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuar të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit <b>[Shtojca 1.2-Rregullore]</b>.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të ankimohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Ankesa bëhet me shkrim brenda 48 orëve dhe i drejtohet</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Dekani të fakultetit, i cili përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos në bashkëpunim me përgjegjësin e Departamentit, që studenti të rijapë provimin, me një komision me anëtarë të tjerë.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Ankesa, procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve në dekanat <b>[Shtojca 2.2-Rregullore e njësisë kryesore]</b>.</p> <p>Studentët kanë të drejtën e rishikimit të tezës së korrigjuar dhe bazuar në rregulloren e UK, gjithashtu kanë të drejtën e ankimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin.</p> <p>Në takimet me studentët nuk na u paraqitën raste të ankimeve, ata u shprehën të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real, gjithësesi ata janë dijeni të rregullores dhe të drejtës së tyre për ankimim <b>[Takimi me studentët]</b>.</p>






Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Bsc. Histori-Gjeografi, është i organizuar sipas përcaktimeve të akteve nënligjore në fuqi dhe i aftë që të thellojë dhe të zhvillojë aftësitë profesionale në dy fusha, histori dhe gjeografi. Programi i studimit Bsc. Histori-Gjeografi zhvillohet në 3 vite akademike me 6 semestra dhe ka 180 ECTS në total. Një vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor të ndarë në dy semestra. Një semestër ka 15 javë mësimore në auditor. 1 orë mësimore = 50 minuta (në praktikë ishte 50, në rregulloren e studimit 60) 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit. Procesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, detyra kursi, prezantime apo praktika [ <b>Rregullore e programit të studimit</b> ].
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit ndihmon përgatitjen e studentëve me njohuri, aftësi e kompetenca të nevojshme profesionale teorike dhe praktike për realizimin e objektivave si dhe pajisjen e tyre me njohuri në fusha të veçanta të komunikimit dhe ndërveprimit. Plani mësimor nuk ka lëndë/module të teknologjisë së informacionit por nga vizita në institucion na u tha që këtë lëndë do ti zhvillojnë në ciklet pasardhëse.
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Dijet e marra, aftësitë dhe kompetencat e përfituara gjatë realizimit të programit të studimit vlerësohen në përfundimin e lëndëve përkatëse me sistemin e notave ku nota 5 është nota minimale kaluese dhe 10 është nota maksimale [ <b>Rregullorja e programit të studimit</b> ].
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Në fillim të çdo viti akademik stafi akademik paraqet në departament syllabusin e lëndës përkatëse në të cilin janë reflektuar përveç te tjerave dhe vërejtje apo sugjerime të studentëve. Në takimet në institucion na u theksua (pasi si mendim është dhe në RVB) që stafi ka marrë sugjerime shumë të vlefshme nga studentët që tashmë janë në tregun e punës. Në përfundim të modulit/lëndës, pedagogu organizon një përmbledhje të temave dhe çështjeve të diskutuara dhe orienton studentët për provimin përfundimtar, mënyrën e organizimit të tij dhe vlerësimit të dijeve [ <b>Takimi me studentët</b> ].
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Departamenti ka krijuar një pervojë të tijën, të organizimit të seminareve tryezave të rumbullakta të përbashkëta student/pedagog, dhe të ftuar. Tematikat e ketyre veprimtarive shkencore lidhen me jubile të ngjarjeve a figurave historike, me çështje të ndryshme aktuale (si çështje trashëgimimë kulturore, bashkepunimi ndërkufitar, probleme demografike, etj) në të cilat rihen mendime e ide, propozohen e rekomandohen veprimeve konkrete. Keto aktivitete kanë patur një impakt
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>të lartë te studentët <b>[Shtojca 3.33 – Kalendar i veprimtarive në Departament]</b></p> <p>Në programin Bsc. në “Histori-Gjeografi” janë angazhuar pedagogë me kualifikim dhe përvojë në mësimdhënie. Pjesa më e madhe e stafit akademik (<i>sidomos në lëndët karakterizuese të kategorisë B, ku është dhe përqëndrimi më i madh i lëndëve</i>), janë specialistë të mirëfilltë të disiplinave të përkatëse (<i>të gjithë Doktor</i>).</p> <p>Programi i studimit në bazë të legjislacionit në fuqi ka një ndërthurje midis punës në auditor dhe punës individuale të studentit jashtë auditorit.</p> <p>Kurrikula e programit të studimit bsc histori dhe gjeografi, reflekton një raport të drejtë mes teorisë dhe praktikës dhe orëve të studimit në auditor dhe atyre të studimit individual, ose 2193 orë në auditor kundrejt 2307 orë praktike. <b>[Shtojca 4 – Tabela 13]</b>. Kjo tregon se studentëve u jepet mundësi e mjaftueshme për të marrë, praktikuar dhe nxënë aftësitë e synuara.</p> <p>Stafi akademik ka marrë pjesë në disa aktivitete shkencore ndërkombëtare dhe bazuar në këtë përvojë por edhe në traditën e UK, format e mësimdhënes janë të përafërta apo gati të njëjta me institucione apo programe si motra.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>				
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënes me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.8</b> <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Për realizimin e provimit final ose diplomës, DHGJ vepron në përputhje me rregulloren e programit të studimit Bsc. “Histori-Gjeografi”, <b>[Rregullorja e programit të studimit, takimi me studentët]</b>. Diplomimi i studentëve të programit të studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi,” realizohet nëpërmjet mbrojtjes së provimit të formimit, ose nëpërmjet mbrojtjes së një teme diplome. Departamenti përgatit fondin e pyetjeve të provimit të formimit <b>[Shtojca 2.15 – Fondi i pyetjeve të provimit të formimit]</b> dhe e vë atë në dispozicion të studentëve gjatë semstrit të pestë të studimeve.</p> <p>Fondi përfshin pyetje nga lëndët bazë e karakterizuese: Gjeografi fizike, Gjeografi social– ekonomike, Gjeografi turizmi, Histori antike botërore, Histori e Ilirëve, Histori mesjetare botërore e shqiptare, Histori bashkëkohore botërore e shqiptare, etj. Mbi bazën e tyre, komisioni i ngritur për këtë qëllim harton tezën e provimit të formimit, e cila miratohet nga Dekani. Teza e provimit përmban 67 pyetje me alternative <b>[Shtojca 2.16– Model teze e provimit të formimit]</b>, që synojnë vlerësimin e njohurive formuese dhe profesionale të studentëve.</p> <p>Departamenti harton listën e fushave prioritare të kërkimit <b>[Shtojca 3.27 – Vendim i Departamentit për përcaktimin e fushave të kërkimit për punimin e diplomës]</b> dhe miraton temat e përzgjedhura nga studentët si</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët</p>	



Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>dhe listën e pedagogëve udhëheqës brenda muajit në ntor të çdo viti akademik. Këtë e bën mbi bazën e propozimeve të miratuara të studentëve. Ai gjithashtu vë në dispozicion të studentëve manualin për punimin e temës të diplomës.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Personeli akademik i caktuar në detyrën e udhëheqësit shkencor, bazuar në cilësimet e përcaktuara në manual, udhëzon, sugjeron dhe vë në dispozicion të studentit material bazë dhe plotësues me synim mbarëvajtjen e procesit të punës studimore të kryer prej tij. Pedagogu udhëheqës ndihmon dhe orienton studentin në punën hulumtuese, në hartimin e pyetësorëve dhe përpunimin e rezultateve, në kryerjen e intervistave apo vëzhgimeve në shërbim të temës së studimit.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Provimi i formimit mbrohet përpara një komisioni të përbërë nga 5 antarë. Vlerësimi bëhet me notë, që është mesatarja e vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit, menjëherë pas përfundimit të provimit. Në rastet kur aplikohet përfundimi i studimeve me mbrojtjen e temës së diplomës, udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Studentëve u ofrohet asistencë për sqarimin dhe saktësimin e detajeve të programit, apo u ofrohen konsultime dhe ju vihen në dispozicion materiale shtesë në funksion të përgatitjes së tyre për provimin e formimit.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, bazuar në legjislacionin në fuqi, por edhe në rregulloren e UK, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga MAS dhe e përgatitur sipas kërkesave të hapësirës europiane të arsimit të lartë. Diploma është një dokument zyrtar i Universitetit të Korçës.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Programi i plotë i tre viteve akademike, sipas rregullores, u jepet vetëm atyre studentëve që e kërkojnë zyrtarisht. Dokumentacioni lidhur me studentin ruhet nga institucioni për një afat kohor të pacaktuar dhe mund të jap informacion për studentët nëse kërkohet.</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Sekretaritë, informacionin për studentin e kanë të ruajtur në tre regjistra:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Regjistrin themeltar të studentëve;</li> <li>2. Regjistrin e arritjeve akademike;</li> <li>3. Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.</li> </ol> <p>GVJ bëri një kontroll të rastësishëm për disa studentë, krahasimi midis notës së marrë në procesverbal dhe notës së hedhur në regjistrin e arritjeve akademike dhe rezultoi korrekt.</p> <p>Në çdo rast që mund të kërkohet informacion nga studentit, sekretaria i kishte gati dhe duke zbatuar procedurën dhe rregulloren, i jepte ato.</p> <p><b>[takimi në institucion me sekretarinë mësimore].</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Të dhënat e institucionit për angazhimin e personelit akademik janë dhënë për një periudhë kohore 3-vjeçare, respektivisht për vitet akademike:</p> <p>VA.2019-2020</p> <p>VA.2020-2021</p> <p>VA.2021-2022</p> <p>Përgjatë vitit 2020-2021 në këtë program studimi janë angazhuar si personel akademik efektiv, përkatësisht 10 lektor, prej të cilëve: 1 PhD, 8 Dr dhe 1 Msc. Ndërsa personeli akademik me kontratë i angazhuar në këtë program përfaqësohet nga 3 lektorë, 1 Prof. Dr, 1 Dr, 1 Msc.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Departamenti i HGJ ka të punësuar 1 personel ndihmës akademik [Shtojca 4. “Tabela Përmbledhëse për Programin e Studimit, Analiza e Departamentit].</p> <p>Nga të dhënat GVJ konstaton se, numri i personelit akademik efektiv ka ardhur në rritje. Ai është dyfishuar, nga 5 PAE që ishin në vitin akademik 2019-2020 në 10 në vitin 2020-2021 dhe 2021-2022. Gjithashtu në të dhënat e vëna në dispozicion nga institucioni jepet informacion edhe për angazhimin në procesin e mësimdhënies së çdo anëtri të DHGJ sipas semestrave dhe vitit akademik. [Shtojca 4 “Tabela Përmbledhëse për Programin e Studimit, Analiza e Departamentit]</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se në zyrën e burimeve njerëzore dosjet e personelit akademik si me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme ishin të plota. Institucioni kishte një dokumentacion të ruajtur dhe të përditësuar me të dhënat e stafit akademik i cili ishte i angazhuar në kuadër të këtij program studimi. [Vizita në Institucion]</p> <p>UNIKO ka një procedurë të përcaktuar për rekrutimin e personelit akademik. Ajo pasqyrohet në dokumentin “Praktikë e rekrutimit të stafit”. Në këtë praktikë përcaktohen:</p>



Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kriteret që duhet të plotësojë kandidati;</li> <li>- Dokumentacionin që duhet të dorëzojë;</li> <li>- Formën e dërgimit të dokumentacionit;</li> <li>- Kohën e dorëzimit të këtij dokumentacioni;</li> <li>- Kohën e marrjes së përgjigjes;</li> </ul> <p><b>[Shtojca 3.34 Praktike e Rekrutimit te Stafit; Vizita në Institucion; RVB]</b></p> <p>Gjatë vizitës në institucion, në takim me Drejtorin e Zyrës së Burimeve njerëzore, u shpjegua që kriteret për rekrutim të stafit propozoheshin nga DHGJ dhe kalonin për miratim në Rektorat dhe më pas vendi i lirë publikohej në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimeve Publike. Konkretisht, procedura e ndjekur për rekrutimin e stafit akademik efektiv dhe atij me kontratë, në kuadër të funksionimi të këtij programi studimi Bachelor ishte:</p> <p>Shpallja para fillimit të vitit të ri akademik në Buletin e Prokurimeve Publike;</p> <p>Bëhet vlerësimi i dosjes nga DBNJ sipas një table të miratuar më parë;</p> <p>Tabela i shkon përgjegjësit të departamentit;</p> <p>Departamenti shqyrton dosjen në zyrën e BNJ të UK; <b>[Minutat e takimeve Bsc Histori-Gjeografi]</b></p> <p><i>GVJ kreu kontrollin e një praktike të rastësishme dhe konkludoi që praktika ishte korrekte në përputhje me deklaratimet e dokumentacionit dhe deklaratimit të drejtuesit të BNJ në UK.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Departamenti evidenton nevojat për personel akademik dhe i paraqet ato në mënyrë të specifikuar Njesisë Kryesore (Dekanati). Pas miratimit nga Drejtoria Juridike dhe Burime Njerëzore njofton Agjencinë e Prokurimeve Publike Tiranë për shpallje konkursi për personael akademik gjithashtu, njoftimi per konkurs per personel akademik kryet edhe në faqen zyrtare të Universitetit “Fan S. Noli” në faqen për programin e Transparencës dhe rrjetet sociale. <b>[Shtojca 3.34 Praktikë e plotë e Rekrutimit të Stafit; Takimi me Drejtuesin e Drejtorisë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore; RVB]</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni realizon vlerësim dhe përzgjedhje të personelit mbështetur në procedurën me dy fazat. Në fazën e parë, kryhet vlerësimi me dosje dhe në fazën e dytë, intervista me gojë në prani të komisionit të ngritur. Universitetit Fan S. Noli mbështetur në dokumentacionin si, Statuti dhe Rregullorja e Organizimi të Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore në Universitetit Fan S. Noli shpall konkurs për personel akademik.</p> <p>Kriteret që duhet të plotësojë kandidati janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të ketë përfunduar studimet universitare në fushën përkatëse, me notë mesatare mbi 8 (tetë)</li> <li>- Të ketë diplomë Master i Shkencave në fushën e kërkuar me notë mesatre mbi (8 tetë)</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të mbrojtur dhe vërtetuar me dëshmi nga UT ose institucione të njohura ndërkombëtare;</li> <li>- Të ketë të paktën 1 vit përvojë pune ose në mësimdhënien univeristare në fushën që do të mbulojë;</li> <li>- Të ketë të dokumentuar veprimtari kërkimore shkencore të fushës përkatëse;</li> <li>- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.</li> </ul> <p>Strukturat përgjegjëse në institucion zhvillojnë procedurën duke iu përmbajtur nevojave për staf akademik sipas profileve të kërkuara nga njësitë bazë. [Shtojca 3.34 Praktikë e plotë e Rekrutimit të Stafit; Takimi me Drejtuesin e Drejtorisë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore; RVB]</p> <p>GVJ konstatoi në kontrollin e dosjeve të aplikantëve që këto kritere zbatoheshin me korrektësi.</p>
--	--



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Universiteti ka mjedis të përshtatshëm për realizimin e detyrave të personelit. Ambjentet e punës janë të paisura me infrastrukturën e nevojshme për realizimin e detyrave nga ana e personelit akademik. Në fondin e bibliotekës së UNIKO gjendet një fond i dedikuar vetëm për fushën Histori-Gjeografi me 437 tituj librash të autorëve kryesisht shqiptarë. Krahas titujve të rekomanduar nga personeli akademik që punon për programin e studimit Bch në HGJ ka dhe një fond librash të dhuruar për periudhën 2016-2021 që ishin në funksion të kryerjes së detyrave të personeli akademik në mënyrë profesionale. [Shtojca 2.21 “Fondi i Bibliotekës FEF”.]
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh konkretisht me këtë fond dhe nga ballafaqimi konsatoi se titujt e librave janë në përputhje jo vetëm me dokumentacionin por edhe në përputhje me objektivat lëndorë të lëndëve/moduleve që zhvillohen në programin mësimor të ciklit të parë Bch në HGJ. <i>Krahas kësaj, GVJ konstatoi se titujt e librave në lëmin e Gjeografisë ishin të pakët në numër krahasuar me ato në lëmin e Historisë. Fondi reflektonte mungesë të titujve me autorë të huaj si në lëmin e gjeografisë ashtu edhe historisë dhe të pesë viteve të fundit. Për këtë do të sygjeromin shtimin e titujve me autorë të huaj dhe rifreskimin me botime të paktën të pesë viteve të fundit.</i> <b>[Vizita në Institucion]</b>



Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Shqyrtimi i dokumentacionit tregoi se institucioni realizon disa nisma të cilat angazhojnë dhe nxisin stafin akademik për zhvillim profesional. Stafi përfshihet në organizimin dhe realizimin e konferencave shkencore, projekteve kërkimore, mobilitete në kuadër të programit Erasmus + etj. Institucioni mbështet përmes skemës së financimit të kërkimit shkencor stafin akademik që realizon botime të artikujve shkencor të indeksuara në Sopus. <b>[shtojca 2.9 “Jetëshkrimi i personelit akademik”], [shtojca 2.19 “Mobilitete Staf Erasmus”], [shtojca 2.24 “Angazhime të stafit akademik të Departamentit Histori-Gjeografi në projekte kërkimore 2016-2021”]</b></p> <p>Nga ballafaqimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion GVJ konstatoi se vetëm një personel akademik ka përfituar nga praktikat për trainimin e stafit nga program ERASMUS+ dhe vetëm një herë, <b>[shtojca 2.19 “Mobilitete Staf Erasmus”]</b> ndërkohë që departamenti përbëhet nga 10 anëtarë. Shkalla e përfshirjes në projekte është realizuar vetëm nga personeli akademik me specializim në fushën e gjeografisë. Gjatë vizitës në institucion nga anëtarët e GVB u ngrit si shqetësim përfshirja në një masë të vogël e anëtarëve të Departamentit HGJ në projektet kërkimore në nivel universiteti dhe mos mbështetja financiare e institucionit të pjesmarrjes së stafit në ngjarje shkencore ndërkombëtare.</p> <p><i>Referuar gjetjeve, GVJ sygjeron që institucioni UK duhet të kontribuojë më shumë në trainimin e anëtarëve të personelit akademik të DHG, veçanërisht në programet ERASMUS+ dhe mbështetjen financiare të punës kërkimore me qëllim nxitjen e personelit akademik në rritjen cilësore profesionale që do të reflektohet në të ardhmen në mësimdhënie cilësore dhe konkurrese. [Vizita në Institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Institucioni realizon trajnime 1-ditore në bashkëpunim me Qëndrën e Metodologjisë dhe Kërkimit për të mundësuar kualifikimin e mëtjshëm të stafit në fushën kërkimore. Gjithashtu marrja pjesë e stafit në programet Erasmus + krijon mundësi për të përfituar nga eksperiencia dhe shkëmbimi i metodave inovative të mësimdhënies. Institucioni mundëson dhe trajnimin e stafit akademik nga zyra e Agjencia e Kërkimit dhe Teknologjisë së Informacionit, Zyra Erasmus + në Tiranë, etj.</p> <p><b>[Shtojca 3.8 Analiza Vjetore “Veprimtaria Akademike 2019-2020” Shtojca 2.24 “Angazhime të stafit në projekte shkencore”. të dhënat mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit; Shtojca 2.19 Mobilitete të personelit akademik].</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Institucioni dëshmon për përpjekje serioze për përmbushjen e objektivave në mbulimin e programit me staf akademik me tituj dhe grada shkencore. Përgjatë vitit 2020-2021 personeli akademik me kohë të plotë i përfshirë në program ka qënë: 1 Phd dhe 8 Dr dhe si lektor me kontrate ka rekrutuar 2 Prof.Dr dhe 1 me gradën Dr. Formimi profesional i personelit akademik është në përputhje me përmbushjen e objektivave që program i studimit BSc në HGJ ka për të realizuar. Personeli akademik me tematikat e përzgjedhura për mbrojtjen e gradës shkencore Doktor përmbush kërkesat për një program cilësor të ciklit të parë BSc në HGJ. <b>[Shtojca 2.9 Jetëshkrimet e stafit të përfshirë në programin e studimit], [Shtojca 4 “Tabela Përmbledhëse për Programin e Studimit].</b></p>



	<p>Gjatë takimit në institucion u informuam nga anëtarët e personelit akademik të DHGJ se, disa prej tyre kanë plotësuar dosjet për kërkimin e tituli Prof. Asoc dhe janë në pritje për ta fituar atë. <b>[Vizita në institucion]</b></p> <p><i>Kjo dëshmon për përpjeket që ata bëjnë në rritjen e shkallës së profesionalizmi me qëllim për ti shërbyer më me cilësi zhvillimit të programit të studimi HGJ.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Departamenti i Histori – Gjeografisë zhvillon procesin mësimor në mjediset e FEF si dhe mjediset e godinës së Rektoratit. Godina e FEFK ka shtrirje prej 1470 m<sup>2</sup> dhe ka në dispozicion 3 laboratorë, 6 salla seminaresh, me 256 vende 2 prej të cilave janë të pajisura me projektorë, si dhe sallën e Bibliotekës shkencore. <b>[Shtojca 4 Tabela përmbledhëse për programin e studimit]</b></p> <p>Nga vizita në instiucion grupi i GVJ konstaton se mjediset e përshkruara në dokumentacion ishin të mjaftueshme dhe të përshtatshme për realizimin e proceseve akademike. Institucioni ka salla të kapaciteteve të ndryshme të ndara në salla leksionesh dhe seminaresh të cilat plotësojnë realizimin e objektivave mësimorë në funksion të 6 studentëve që ka ky program. Studentët e programit “Histori-Gjeografi” kanë patur në dispozicion një infrastrukturë fizike, didaktike dhe logjistike për përmbushjen e realizimit si të orëve teorike ashtu edhe moduleve specifike. <b>[Vizita në institucion; RVB]</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Në UNIKO, mjediset mësimore ku zhvillonin procesin mësimor studentët e programit Bsc. “Histori-Gjeografi garantonin realizimin e procesit mësimor. Kjo sepse Departamenti i “Histori-Gjeografi ka në funksion të plotë laboratorin e dedikuar për këtë program, atë të, “Laboratori i Gjeografisë”, në godinën e Rektoratit. Laboratori është i paisur me 10 kompjutera, priter / fotokopje / skaner, projektor dhe kendi i hartave historike dhe gjeografike. Në të është instaluar programi <i>Arc Gis 10.1</i> i cili, përdoret për orët e praktikës për lëndën e Hartografisë dhe programi <i>Sistemi GIZ</i> në turizëm.</p> <p>Dokumentacioni argumentues që shoqëron RVB tregon se departamenti zotëron një fond të pasur hartash historike e</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	



<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron</p>	<p>gjeografike, të cilat në lëndë të veçanta luajnë një rol të rëndësishëm didaktik-praktik dhe kanë një rëndësi të madhe e përdorim të gjerë, në mënyrë të veçantë në lëndë/module specifike të pjesës së Gjeografisë.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p><i>GVJ konfirmoi se mjedisi logjistik dhe në veçanti infrastruktura didaktike ishte e aksesueshme në çdo kohë, për studentët dhe stafin akademik. [Vizita në institucion]. Gjatë vizitës në laboratorin e e gjeografisë u njohëm me mënyrën sesi studentët përdornin programin Arc Gis 10.1 dhe Sistemin GIZ. Gjithashtu njohja u thellua edhe me shumëllojshmërinë e hartave dhe instrumenteve të tjera hartografike që përdoren nga personeli akademik dhe studentët në laborator. Për realizimin e detyrave të studentëve të programit HGJ bashkëpunohet edhe me laboratorin e teknologjisë së informacionit, i cili mbështeste fort këtë program studimi. [Vizita në Institucion]</i></p> <p>Kapacitetet e UK “Fan S. Noli” dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera mundësojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e veprimtarive praktike dhe aktiviteteve të tjera. [RVB;] Mjediset mësimore si klasa, auditorë e laboratorë mundësojnë realizimin e procesit mësimor.</p> <p><i>Nga vëzhgimi i drejtëpërdrejtë i auditorëve, laboratorëve, programeve të reja kompjuterike, bibliotekës gjatë vizitës u konstatua se mjediset mësimore dhe ato ndihmëse janë të pajisura me lidhje interneti dhe me pajisje elektronike të teknologjisë së informacionit duke siguruar përdorimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies/mësimnxënies në varësi të numrit të studentëve dhe grupeve mësimore teorik dhe praktik mësimor. [Vizita në institucion]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në nivel universiteti, UNIKO vendos në shërbim të studentëve Bibliotekën Universitare dhe bibliotekat për çdo fakultet. Biblioteka e FEF garanton të drejtën e çdo studenti për, aksesim të bibliotekës përmes procedurës së regjistrimit dhe hapjes së kartelës për shfrytëzimin e literaturës fizike dhe ambjenteve të mjediseve të brendshme dhe të jashtëme të saj. Gjithashtu studentët mund të shfrytëzojnë shërbimin e internetit nga mbulimi i të gjithë hapsirës së bibliotekës me rrjetin Eireless dhe të aksesohen në biblioteka on-line.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë</p>	

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka Universitare ka 25 734 tituj me rreth 12000 tituj dhe 230 vende leximi dhe ka infrastrukturë për aksesimin e titujve të librave në bibliotekat online. Biblioteka “Kongresi i Manastirit” në FEF disponon një fond prej 7710 titujsh. Prej tyre, rreth 1716 janë libra me tematikë historike dhe gjeografie. Edhe më i pasur me tituj historik është fondi i Bibliotekës shkencore në Rektorat. Ndër to mund të përmendim botimet e Akademisë së Studimeve Albanologjike, botimet e Institutit për Krimet e Komunizmit, Instituti “Lumo Skendo” Botime të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Kosovës, Instituti i Studimeve Shqiptare e Protestante. <b>[Inventari i teksteve për fushën e programit të studimit Bch në “Histori-Gjeografi”; RVB]</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua nga punonjësja e bibliotekës mbi procedurat e pasurimit të fondit të bibliotekës. Biblioteka e Universitetit Fan S. Noli-it për programin e studimit ka kënd të dedikuar me libra në lëmin e “Histori-Gjeografi”. <b>[Vizita në Institucion]</b>. Më shumë detaje referoju <i>Standartit IV.2. Kriteri1 ku çështja saqrohet më hollësisht.</i></p> <p>Biblioteka është e paisur me dy salla:</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>1.Salla për praktika lëndore/profesionale 2. Salla për aktivitete promovuese. <b>[Shtojca 4 Tabelë përmbledhës për programin e studimit, Fq 14]</b>. Krahas bibliotekës institucioni vë në dispozicion të studentëve edhe mjedis për fotokopjime, librari. Gjithashtu institucioni ka siguruar akses dhe në biblioteka online duke i mundësuar studentëve literaturën më të fundit. <b>[RVB; Inventari i teksteve për fushën e programit të studimit BCH “Histori-Gjeografi”; Praktikat e dhurimit të librave, Propozimet për pasurimin e fondit të bibliotekës]</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Regjistrimi dhe përdorimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në bibliotekë është papagesë për studentët dhe stafin akademik. <b>[Vizita në Insitucion; Takimi me punonjësën e bibliotekës]</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Bibliotekat janë të pajisura me lidhje interneti dhe poste kompjuterash të cilët mundësojnë aksesin e studentëve në biblioteka online, në të cilat UNIKO kryen abonim, në: U – library, EBSCO dhe PROQUEST. Studentët krijojnë llogaritë e tyre personale në këto rrjete dhe shfrytëzojnë literaturën e nevojshme sipas profilit kërkimor. <b>[Vizita në Insitucion; Takimi me punonjësën e bibliotekës]</b></p> <p>UNIKO ndjek një praktikë të pasurimit të fondit të bibliotekës sipas kërkesave që vinë nga njësitë bazë. Përgjegjësit e programit të studimit përmes kërkesave të marra nga personeli akademik me titujt e propozuar i përcjellin ato në Dekanat. Nga takimi që patëm me punonjësën e bibliotekës na u konfirmua fakti që institucioni i merr në konsiderat kërkesat e stafit akademik dhe realizimi i procedurës për pasurimin e fondit realizohet në mënyrë periodike. <b>[RVB; Takimi me punonjësën e bibliotekës]</b></p> <p>Biblioteka qëndron e hapur nga e hëna në të shtunë. Përgjatë javës orari i funksionimit të bibliotekës është 8.00-16.00. Oraret e bibliotekës ishin në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Gjithashtu studentët kishin mundësinë të tërheqin literaturë për shfrytëzim jashtë ambienteve të bibliotekës. <b>[Takimi me punonjësën e bibliotekës]</b></p>

	Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se studentët kishin mundësi të shrytëzonin bibliotekën gjatë hapsirave të lira kohore dhe të aksesoheshin në biblioteka on-line deri në orarin e mbylljes së saj.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UNIKO ka një sistem të menaxhimit të informacionit të quajtur “Programin Digjital të Sistemit Universitar ESSE3” të instaluar sipas përcaktimeve të marrëveshjes me RASH. Përmes këtij programi informatik realizohet ruajtja, administrimi dhe përpunimi i të dhënave të studentit nga regjistrimi deri në diplomim. Sistemi, ndër të tjerash, përmban të dhënat personale të studentit, regjistrimin e notave etj. <b>[RVB; Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik ESSE 3, Manuali i përdorimit të sistemit ESSE 3,]</b>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi digjital ESSE3 mundëson komunikimin, informacionin dhe materialet që lidhen me procesin mësimor ndërmjet stafit akademik dhe studentëve në kohë reale. Ky sistem mundëson lehtësira si për studentët pasi ata informohen mbi rezultatet e testimit, njoftime, materialet e lëndëve etj ashtu edhe për stafin akademik që dokumenton punën e tij përmes sistemit. Një tjetër aspekt i rëndësishëm që menaxhohet dhe administrohet nga ky system është dhe veprimtaria e sekretarisë mësimore duke plotësuar bashkëpunimin e të tre komponentëve Student/sekretari mësimore/personel akademik. <b>[Manuali i përdorimit të sistemit ESSE 3; RVB]</b>
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	UNIKO përmes sistemit të menaxhimit që përdorë, në bazë të programeve të studimit mundëson aksesin e dedikuar për stafin dhe studentët. Përmes sistemit ESSE 3 institucioni mundëson dokumentacionin dhe komunikimin midis studentëve dhe stafit. Përdormi në nivel institucional i këtij sistemi mundëson monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik.
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se format e mbështetjes së sistemit për personelin akademik ishin: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Publikimi online i kurrikulës së programit të studimit,</li> <li>2. Monitorimi i planit mësimor,</li> <li>3. Regjistrimi në sistem i personelit akademik përgjegjës për lëndën/modulin dhe atë ndihmës mësimor,</li> <li>4. Raportimi mbi ecurinë e plotësimi të afateve të përcaktuara në Manual. <b>[Manuali i përdorimit të sistemit ESSE 3; Vizitës në sekretarinë mësimore, RVB]</b></li> </ol>
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Format e mbështetjes për studentët ishin: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngarkimin e detyrave të kursit,</li> <li>2. Ngarkimin e projekteve</li> </ol>



	<p>3. Marrjen e leksioneve të ngarkuara nga personeli akademik</p> <p>4. Marrjen e vlerësimeve</p> <p>Personeli ndihmës akademik ndihmon studentët duke ju vënë në dispozicion një sekretari online në kohë reale dhe nga çdo vend, për t'iu bërë të ditur:</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>1. Grafikon e provimeve.</p> <p>2. Notat e provimeve</p> <p>3. Lajmërime apo informacione të dërguara nga pedagogët apo departamenti</p> <p>4. Vërtetime të ndryshme</p> <p>Në UNIKO krahas sistemit ESSE 3 është përdoruar e Mikrosoft Team. Ai ka krijuar mundësinë e komunikimit interaktiv dhe në kohë reale. Përmes kësaj platforme realizohen shkëmbime të informacionit midis stafit akademik dhe studentëve. <b>[Manual i mësimit online, RVB]</b></p> <p>Platforma Microsoft Team mundëson monitorimin e aktivitetit akademik nga strukturat e NJSBC-së dhe jo vetëm. Nëpërmjet kësaj platforme merren të dhëna dhe realizohen raporte mbi aktivitetin e përdorimit të saj nga anëtarët e personelit akademik.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues të programit të studimit Bsc. në HGJ GVJ konstatohet se sistemi ESSE3 kontrollon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Autenticitetin e informacionit identifikues të përdoruesit;</li> <li>➤ Autorizon aksesin e përdoruesit në të gjitha funksionet/operacionet;</li> <li>➤ Ruan privatësinë e të dhënave.</li> </ul> <p>Nëpërmjet këtij sistemi institucioni mund të monitoroj në kohë reale aktivitetin mësimor të personelit akademik dhe administrativ. Me të dhënat reale të grumbulluara mund të hartohen raporte monitorimi rreth performancës së procesit mësimor si nga personeli akademik, ndihmës por edhe pjesmarrjes së studentëve në frekuentimin dhe zhvillimin e procesit mësimor. Të dhënat e grumbulluara iu vihen në dispozicion titullarëve të njësisë kryesore edhe të njësisë bazë. Nga databaza e krijuar krijohet një panoramë e qartë rreth hedhjes në kohë të dokumentacionit të kërkuar, përmbushjen e kriteve të vlerësimit dhe respektimin e afateve të hedhjes së rezultateve online. Sistemi ESSE3 ka aksesin e tij nga faqja zyrtare e internetit të UNIKO. <b>[Linku për aksesim në sistemin ESSE3]</b></p> <p>GVJ provoi të hynte në faqen e internetit të UNIKO por konstatohet që ajo ishte në punë e sipër dhe nuk mund të konfirmojmë informacionin e kërkuar lidhur me gjuhën e hedhjes së informacionit në internet.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi IV.6**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ bazuar në RVB konstaton se raporti financiar hartohet në nivel institucioni gjatë muajti tetor të çdo viti. UNIKO nëpërmjet Drejtorisë së Financave dhe Drejtorisë Ekonomike harton raportin vjetor të veprimtarisë financiare të UNIKO në të cilin përfshihet raporti financiar i kostove të programeve të studimit dhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi. <b>[Rregullorja financiare e UNIKO 156 Shtojca 1.7 – Rregullore e Drejtorisë Ekonomike &amp; Shtojca 1.8 – Rregullore e Drejtorisë Financiare 157 Shtojca 3.15 – Parashikimi i kostove financiare të programit të studimit RVB]</b> Mbështetur në RVB burimet e financimit të UNIKO janë: A. Transfera nga Buxheti i Shtetit, B. Tarifa vjetore e studentëve për arsimim, C. Donacione dhe burime të tjera financimi, D. Të ardhura të akumuluar për shërbimet e ofruara, E. Të ardhura të gjeneruara nga marrëdhëniet me palët e treta, F. Të ardhura nga organizimi i veprimtarive kërkimore – shkencore. <b>[RVB]</b>
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	Përgjegjësi i njësisë që mbulon programin e studimit bënë planin e financimit të një program studimi, etj. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për planin e financimit të një program studimi nga UNIKO rezulton të jetë një dokument me emërtim “Planifikimi për kostot financiare për departamentin e Historisë-Gjeografisë” i hartuar nga përgjegjësi i DHGJ. Ky dokument përmban informacion rreth këkresave që departamenti ka për mallra dhe shërbime (materiale zyre, transporti, praktika mësimore, ekspedita, konferenca, honorare, investime financim i brendëshëm dhe financime të jashtme. <b>[Shtojca 3.15 – Parashikimi i kostove financiare të programit të studimit, RVB]</b> Nga të dhënat GVJ konstaton se ka mungesë të informacionit nga ana e institucionit për masën e financimit të burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, të financimit për bibliotekën dhe pasurimin e saj, të vlerës së granteve vendëse apo të huaja, apo vlerën e kontratave të shërbimeve që lidhen me realizimin e programit të studimit. Plani i financimit është sipërfaqësor dhe jo i dedikuar për programin e studimit por për nevojat e departamentit. Bazuar në RVB, UNIKO kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. Ky raport paraqitet prej administratorit të universitetit pranë Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. <i>GVJ mbështetur në dokumentacionin mbështetës konstaton mangësi. Në listën e dokumentave mungojnë të dhëna të detajuara lidhur me</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	
<b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe plani fikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka	





<p>kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p><i>të ardhurat e akumuluar dhe ndarjen e burimeve financiare, nu ka një raport specifik financiar.</i></p> <p>Bazuar në RVB raportet përmbajnë transparencë përsa i takon kontabilizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve. Në nivel institucioni raportet janë periodike, të përvitshme. Sikundër është theksuar dhe më lartë për këtë program studimi nuk ka një raport specifik financiar. <b>[RVB]</b></p> <p><i>Institucioni nuk ak parqitur raporte financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe GVJ nuk ka informacion për planifikimin e ndërhyrjeve të posaçme të financimit të programit.</i></p> <p>UNIKO si institucion public i arsimit të lartë i siguron burimet e financimit nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>A. Granti që akordohet nga MAS,</li> <li>B. Të ardhurat që siguron institucioni nga vjelja e tarifave të regjistrimit, tarifat e shkollimit, si dhe të ardhura nga shërbime të tjera që ofron institucioni.</li> </ul> <p>Qëndrueshmëria financiare e UNIKO garantohet nga fondi i pakushtëzuar që akordon MAS dhe tarifat e regjistrimit. <b>[RVB]</b></p> <p>GVJ, bazuar në vizitën në institucion dhe takimin me përfaqësues të GVB dhe Stafin Akademik, u informua se politika e mbështetjes mundësohet nga qëndrueshmëria financiare dhe forma e menaxhimit të qëndëruar duke mundësuar shpërndarjen e kostove në nivel institucion. [Takimi në Institucion]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<b>X</b>	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<b>X</b>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomiminë programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Institucioni ka një kuadër të plotë të hartimit dhe zbatimit të procedurave për zhvillimin e aktivitetit akademik si: Statut, Rregullore Universitetit, Strategji, Vendimet e Senatit Akademik, Rregullore e Programit të studimit e deri tek Dok. D.I. “Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve”. Në dokumentin D.I “Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve” bëhet e qartë politika që ndjek institucioni dhe kriteret e pranimit për të tre ciklet e studimit që ofron ky universitet.</p> <p>GVJ konstatoi se politikën e ndjekura në institucion janë konform legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatore të universitetit.</p> <p><b>[RVB; Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve]</b></p> <p>Bazuar në dokumentacionin shoqëruar të programit të studimit Bsc. në HGJ, në dokumentin “Praktika e informimit të studentëve me programin e studimit” pasqyrohet procedura e informimit të studentëve të viteve të para me programin e studimit HGJ i cili përmban njohuri rreth:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Format e organizimit të programit të studimit në UNIKO, mbështetur në deklaratën e Bolonjës</li> <li>2. Format e njehësimit</li> <li>3. Organizimi i Universitetit UNIKO (fakultete e departamente)</li> <li>4. Njohja me dokumente të rëndësishme (Statute UK, Rregullore UK, rregullore e sistemit ESSE3, Kodin e etikës)</li> <li>5. Njohja me programet me karakter profesional, ciklit të parë, ciklit të dytë master profesional dhe shkencor, cikli I tretë I studimeve</li> <li>6. Njohja me systemin e krediteve ETSC</li> <li>7. Struktura e vitit akademik</li> <li>8. Mësimdhënia (frekuentimi sipas rregullores)</li> <li>9. Organizimi i provimeve</li> <li>10. Sistemi i vlerësimit</li> <li>11. Njohja me rezultatet dhe procedura e riprovimit</li> <li>12. E drejta e studentit për përmirësim note <b>[Shtojca 3.9. Praktika e informimit të studentëve me programin e studimit]</b></li> </ol>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	



<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyruar GVJ konsatoi se që në hyrje të studimeve e deri në diplomim, studentët informohen vazhdimisht mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si; <b>kriteret e pranimit, procedurat e regjistrimit dhe tarifit, transferimi i studimeve dhe mobilitetet, këshillimin e studentëve, të drejtat e përfaqësimit, veprimtari akademike, kulturore, njoftime.</b> Gjatë vizitës në institucion, në takimin me studentët edhe përfaqësuesit e Qendrës së Karrierës dhe Alumni, GVJ u njoh me format e informimit që ishin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Veprimtari informuese që organizon vetë departamenti,</li> <li>2. Informim nga pedagogët</li> <li>3. Informim nga strukturat administrative në Rektorat.</li> <li>4. Informacioni i marrë në faqen zyrtare të internetit.</li> <li>5. Informacioni vihet në dispozicion të një publiku më të gjerë me anë të njoftimeve të Qendrës së Karrierës dhe Alumni në ëbsite-in zyrtar të UNIKO për studentët e universitetit dhe llogaritë zyrtare të krijuara nga QKA në rrjetet sociale.</li> </ol> <p>Të gjitha format e renditura u japin mundësi të barabartë të gjithë studentëve për të qenë të informuar. Gjithashtu mundësi të barabartë iu ofrohet edhe kandidatëve për student në këtë universitet nëpërmjet shpalljes së detyrueshme të listës së studentëve fitues në programin e studimit në stendën e e njoftimeve të universitetit edhe në faqen zyrtare të UNIKO.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p><i>Nga verifikimi GVJ konstatoi se listat e fitueseve ishin të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Në dokumentacionin e shqyrtuar si Statuti I UNIKO, Rregullore e UNIKO dhe dokumenta të tjerë, vërehet që kriteret dhe procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes janë të kuptueshme dhe të aksesueshme. Studentët kanë mundësi që të aksesojnë kriteret e pranimit dhe të njohin procedurat qoftë nëpërmjet vizitës në institucion, takimeve informuese, broshurave dhe nëpërmjet faqes zyrtare të UNIKO dhe veçanërisht të Qendrës së Karrierës dhe Alumni.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të</p>	<p>Kriteret specifike (nëse ka) propozohen nga Departamenti dhe miratohen nga Senati Akademik. Ky informacion është i aksesueshëm pasi publikohet në faqen zyrtare të universitetit. <b>[Shtojca Kriteret e pranimit: <a href="http://172.16.0.2/kriteret-e-pranimit">http://172.16.0.2/kriteret-e-pranimit</a> ], [Shtojca 3.9 – Praktikë propozimi për kriteret dhe kuotat e pranimit] <a href="http://www.c1a9-80-78-64-96.ngrok.io/sq">http://www.c1a9-80-78-64-96.ngrok.io/sq</a></b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Pranimi i studentëve në programin e studimit Bachelor “Histori - Gjeografi” kryhet sipas kriterëve, procedurave dhe afateve të miratuara në bazën ligjore institucionale Hartimi i kriterëve për përzgjedhjen e kandidatëve kryhet përpara fillimit të regjistrimit, përgjegjësi i departamentit të HGJ në FEF bënë publike kriteret dhe procedurën e pranimit për programet e ciklit të parë të studimit. Sipas dokumentit “Praktika e Miratimit të Kriterëve të Pranimit” drejtuar dekanit të FEF për programin e studimit Bachelor në Histori-Gjeografi pragu minimal i notës mesatare të studimeve të përgjithshme do të jetë 7.5. Renditja e kandidatëve fitues bëhet sipas mesatres së përgjithshme të shkollës së mesme duke përfshirë edhe rezultatet e provimeve të maturës shtetërore. <b>[Shtojca 3.9 – Praktikë propozimi për kriteret dhe kuotat e pranimit]</b></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

	<p>Propozimi miratohet në Dekanat dhe i përcillet për miratim Senatit Akademik në përputhje me standartet shtetërore të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore. Në këto kuota Departamenti parashikon:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kuota brenda Vendit</li> <li>2. Kuota për kandidatë nga Trojet Shqiptare.</li> <li>3. Kuota për persona me statusin e aftësi të kufizuar</li> <li>4. Kuota për shtetas të huaj</li> <li>5. Kandidatë me statusin e Jetimit</li> <li>6. Kandidatë rom dhe ballkanso-egjiptian</li> <li>7. Kandidat që aplikojnë për transferimstudimesh</li> <li>8. Kandidat që aplikojnë për cikël të dytë studimi</li> <li>9.</li> </ol> <p><b>[Shtojca 3.9 – Praktikë propozimi për kriteret dhe kuotat e pranimit]</b></p> <p>GVJ konstatoi se kriteret e përgjithëshme dhe specifike kryhen me procedurë të rregullt dhe në përputhje me aktet nënligjore. Institucioni ka disa forma të informimit dhe orientimit mbi kërkesat e kriteret që ka programi i studimit si: takimet informuese në institucion; përdorimi i faqes zyrtare; rrjeteve sociale etj.</p> <p><b>[ 2. 5 - Rregullore e programit Bachelor “Histori – Gjeografi” 2019-2020], [Shtojca 3. 10 - Praktika e promovimit dhe informimit të maturantëve], [Shembull - Universiteti "Fan S. Noli", Korçë - UNIKO - Postime   Facebook], [Referoju Kriterit 2 dhe 3 të këtij standarti]</b></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.2



**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Nga shqyrtimi i rregulloreve të programit të studimit dhe dokumentacionit shoqërues studentët marrin informacion të hollësishëm rreth:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Frekuentimit (për të cilin studenti informohet për masën 75% të frekuentimit të detyrueshëm, frekuentim e detyrueshëm të punëve të laboratorit në masën 100%, projektet duhen të shlyen në masën 100%, në të kundërt student nuk hyn në provim)</li> <li>2. Llojet e provimeve (me shkrim, me gojë dhe të kombinuar)</li> <li>3. Mos lejimi i nëdërrimit të tezës</li> <li>4. Në orën e fundit të mësimit personeli akademik i komunikon studentit fitimin ose jo të të drejtës për tu futur në provimin e lëndës dhe rezultatin e vlerësimit të vazhdueshëm në seminare, laboratore, tema e detyra kursi.</li> </ol>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e	

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

aftësive të studentëve në programin e studimit.	5. Dy ditë përpara provimit vendos online këto rezultate dhe printon listën emërore të studentëve të regjistruar.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	6. Lejohet ndërimi i tezës por ndëshkohet me një zbritje prej dy naotash nag sistemi i notave me dhjetë pikë. 7. Personeli akademik bën me dije studentët për rezultatet e provimit me shkrim dhe gojë brenda 6 ditëve, në rast se student nuk informohet në kohë e merr këtë informacion në sekretarinë mësimore.
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	8. Çdo student ka llogarinë e tij ku njihet me rezultatin e provimit dhe notën përkatëse.  UNIKO ka një rregullore mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin ku bazohet realizimi i procedurës dhe informim i studentëve mbi këto procese. Gjithashtu, zyra ndaj kujdesit të studentit në bashkëpunim me departamentin dhe sekretarinë mësimore informojnë dhe lehtësojnë studentin me vlerësime paraprake për transferim studimesh apo njohje të tyre. Studentët mund të aksesojnë informacion lidhur me procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparëshme ose të pjesëshme nëpërmjet faqes së Eëb-it të UNIKO. <b>[RVB; Shtojca 3.36 – Praktikë transferimi studimesh dhe ekuivalentimi krediteve]</b> <i>GVJ u pëpoq të provonte të aksesonte në Eëebin e UNIKO por faqja ishte në punim e sipër.</i>

Informimi i studentëve lidhur me kriteret e proceduarat e vlerësimit të dijeve realizohet në disa forma:



- A. Nëpërjet rregulloreve të programit të studimit,
- B. Nëpërmjet praktikës së informimit të studentëve të viti të parë të programit HGJ
- C. Nëpërmjet syllabuseve lëndore që jepen nga personeli akademik në orën e parë të fillimit të çdo lënde.
- D. Nëpërmjet personelit akademik në fillim të çdo semestri
- E. Rregullorja e programit të studimit dhe silabuset aksesohen online nga studentët. **[Rregullore programit të studimit 2021-2022]**

*GVJ konstaton se informimi i studentëve lidhur me proceduarat e vlerësimit është i larmishëm dhe i shtrirë në disa plane. Kjo u konfirmua edhe gjatë takimit me student në ditët e vizistës në institucion.*

Departamenti HGJ në FEF ka hartuar një udhëzues për punimin e diplomës, të cilin e bënë të njohur për studentët në seanca informimi të dedikuara për këtë qëllim. Personeli akademik dhe përgjegjësi i departamenti i njohin studentët me këtë udhëzues të shpërndarë në rrugë elektronike. **[RVB], [Shtojca 2.2 – Rregullore e FEF, Kreu VI 174 Shojca 2.5 – Rregullore e programit të studimit, Mbi punimin e diplomës/disertacionit; Takimi me GVB; Takimi me Studentët].**

Gjatë takimit në institucion GVJ konfirmoi informacionin e marrë nga RVB dhe nga takimi me anëtarët e GVB dhe nga takimi me studentët për zbatimin konkret të këtij procesi. Por gjurmë të kërrij procesi nuk kemi.

Nga shqyrtimi i RVB-së dhe takimi me stafin akademik rezulton se institucioni organizon në fillim të vitit akademik “Javën e orientimit”. Gjatë



	<p>kësaj jave personeli akademik i departamentit të HGJ i njeh studentët me udhëzuesin "Praktikën e Informimit të Studentëve për Programin e Studimit. Përgjatë javëve të regjistrimit, institucioni vendos grupe pedagogesh për të informuar studentët e interesuar. Gjithashtu mbledhjet e departamentit janë të hapura për studentët e interesuar. Përgjatë javëve të regjistrimit, institucioni vendos grupe me personel akademik, për të informuar studentët e interesuar. Gjithashtu mbledhjet e departamentit janë të hapura për studentët e interesuar. [Takimi me studentët]. GVJ e konfirmoi informacionin për zhvillimin e javës së orientimi dhe paisjen me udhëzuesin edhe nga takimet që zhvilloi me studentët e programit të studimit BCh në HGJ, gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu studentët u shprehën të kënaqur nga puna promovuese e anëtarëve të personeli akademik të DHGJ. Përgjatë javëve të regjistrimit, institucioni angazhon grupe personel akademik për të informuar studentët e interesuar. Gjithashtu mbledhjet e departamentit janë të hapura për studentët e interesuar.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	<p>Institucioni ka disa forma të informimit të studentëve përsa i takon njohjes me strukturën dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Nëprmet sesionit informues që realizohet në fillim të ciklit të parë të studimit.</li> <li>2. Nëprmet rregullores së programit të studimit</li> <li>3. Nëprmet syllabuseve lëndorë.</li> <li>4. Nëprmet personelit akademik të departamentit të HGJ.</li> <li>5. Nëprmet afishimeve në këndin e njoftimeve në hollin e FEF.</li> <li>6. Në monitorët e vendosur në mjediset e Fakultetit FEF ku zhvillohet program i studimit HGJ.</li> </ol>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>[RVB; Vizita në Institucion]</p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>Që në momentin e regjistrimit, studenti pajiset me programin e studimit që përmbanë lëndët dhe modulet e tij. UNIKO siguron akses dhe informacion për studentët në lidhje me elementët e programit të studimit që ata ndjekin përmes sistemit ESSE 3 dhe stafit akademik që realizon programin.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se Institucioni kontrollon marrjen apo jo të informacionit nga studentët për modulet, lëndët, metodën e vlerësimit dhe detyrat detyrat që dotë zhvillohen gjatë kursit, nëpërmjet pyetësorëve që i realizon në fund të çdo semestri.</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p><i>Kjo vlerësohet nga GVJ si një punë shumë e mirë që bëhet nga ana e institucionit për vrojtimin në mënyrë sistematike të masës me të cilën përmbushet marrja e informacionit nga studentët.</i></p> <p>Institucioni ka disa struktura që adresojnë vënien në kontakt të studentëve me mundësitë e punësimit. Institucioni organizon panairë të tregut të punës si dhe ka strukturën e bordit të tregut të punës që mundëson lidhjen e studentëve të punësuar me universitetit. Gjithashtu zyra e QKA bënë njoftime për mundësi punësimi. <b>[Takimi me përfaqësues të Qendrës së Karrierës dhe Alumnit, RVB;]</b></p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimet e realizuara u informua mbi sistemin dhe strukturat përgjegjëse për informimin e studentëve mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. Institucioni, përmes koordinorit të programit të studimit mban komunikim dhe informon tek studentët njoftimet që lidheshin me procesin mësimor. Gjithashtu njoftimet vendoseshin dhe në këndin e njoftimeve. Njoftimi realizohej dhe në rrugë elektronike përmes postes elektronike të studentit. <b>[Vizita në Institucion, takimi me student]</b></p> <p>Në takimin e realizuar me studentët e programit Bch “Histori-Gjeografi” u vërejt fakti se ata vlerësonin sistemin ESSE 3. Sipas studentëve, sistemi u krijonte shumë lehtësi në komunikimin me stafin akademik të angazhuar në program, aksesin e leksioneve në formatin elektronik dhe çdo informacion tjetër që lidhet me organizimin e programit mësimor. <b>[Takimi me studentët]</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ pa fizikisht dokumentacionin që lidhet me statistikat vjetore për numrin e studentëve të diplomuar në Bch “Histori-Gjeografi”. Institucioni disponon statistika për studentët e diplomuar në vitin akademik 2019-2020. <b>[RVB]</b></p> <p>Viti Akademik 201-2020 30/kuota e 8/regjistrime</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p>	<p>Viti Akademik 2020-2021 30/kuota e 17/regjistrime</p> <p>Viti Akademik 2021-2022 30/kuota e 4/regjistrime</p> <p><b>[Takimi në sekretarinë mësimore]</b></p> <p>Në vizitën e realizuar në institucion dhe takimin me sekretarinë mësimore, GVJ iu vunë në dispozicion të dhëna që lidheshin me numrin e studentëve të regjistruar në program, ata që ishin çregjistruar dhe ata që ishin me status aktiv. Institucioni disponon të dhëna vjetore për programin BSC “Histori-Gjeografi”. Gjithashtu përmes sistemit ESSE3 institucioni i disponon statistikat në çdo kohë. <b>[Minutat e Vizitës; Takimi në sekretarinë mësimore]</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të</p>	

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.aseaf.al

studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Në shqyrtimin e dokumentacionit është konstatauar se institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi deri në diplomimin. Në analizën vjetore të departamentit të HGJ trajtohet në mënyrë të veçantë numri i studentëve të regjistruar sipas programeve të studimit, numri i studentëve përsëritës, kalueshmëria dhe nota mesatare e të diplomuarëve. <b>[Shtojca Dokumenta shpesh për programin HGJ-Analizë vjetore për vitin akademik 2020.2021]</b>			
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigura dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ gjatë vizitës në UNIKO u informua se institucioni disponon për çdo student dosjen me të gjitha të dhënat që nga momenti i fillimit të programit dhe deri në përfundimin e tij. Në sekretarinë mësimore u njohën me dosje studentësh të zgjedhura në mënyrë rastësore. <b>[Takimi në sekretarinë mësimore; RVB]</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	UNIKO menaxhon të dhënat statistikore të studentëve përmes sekretarisë mësimore e cila ka të dhënat personale të studentëve, numrin e telefonit, adresat e email-it, dhe ruan kontakte me studentët në raste njoftimesh. Të dhënat personale të tyre si datëlindja, qyteti i lindjes, adresa kontakti ruhen nga sistemi në mënyrë diskrete dhe janë të sigura dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat TI-it të autorizuar në fakultet dhe rektorat. Gjithashtu ruajtja, administrimi dhe përpunimin i të dhënave të studentëve realizohet edhe nga sistemi ESSE 3. Në këtë rast zyra e IT-së është përgjegjëse për administrimin e të dhënave në sistem. <b>[RVB]</b> Për programin e Studimit Bch “Histori-Gjeografi”, departamenti ka realizuar një analizë mbi arritjen e objektivave formues të programit të studimit. Ky dokument analizon komponent të ndryshëm të këtij programi studimi. <b>[Shtojca 2.20 – Raport i analizës së veprimtarisë mësimore dhe kërkimit shkencor në UNIKO, 2019 – 2020, Shtojca IV, V 187 Shtojca 2.21 – Raporti i analizës së veprimtarisë mësimore dhe kërkimit shkencor në FEF, 2019 – 2020, 57 188 Shtojca 3.8 – Analiza vjetore e Departamentit “Histori – Gjeografi” 2019 – 2020, 17]</b>  <i>GVJ e konfirmoi hartimin e raporteve analitike periodike si nëpërmjet dokumenteve ashtu edhe në takimin me përgjegjësin e departamentit të programit të studimit dhe takimin me personelin akademik.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi V.5**



**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet	Bazuar në Statutin e UNIKO, studentët përfshihen në disa struktura drejtuese me karakter mësimor-kërkimor dhe shërbime. Përfaqësuesit e studentëve përfshihen në struktura si:



Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	<ul style="list-style-type: none"> <li>A. 1 student në Bordin e Administrimit</li> <li>B. 2 studentë në Senat Akademik;</li> <li>C. Këshilli i Studentëve;</li> <li>D. Këshillat e Studentëve në nivel njësie kryesore;</li> <li>E. 1 student në Këshillin e Etikës;</li> <li>F. 1 student në NJSBC; <b>[Përfaqësimi i studentëve në organizmat institucional]</b></li> </ul>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	<p><i>Dokumentacioni shoqërues tregon se UNIKO është në zbatueshmëri të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, studentët kanë të drejtë të përfaqësohen në Senatin Akademi, në Bordin e Adminsitrimit, në Komisionin e Etikës, në komisionet zgjedhore, në zgjedhjet për Rektorin e universitetit dhe Dekanin e Fakultetit.</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	<p>Krahas detyrimeve të përcaktuara në Statut dhe Rreguloren e UNIKO, institucioni përdor disa forma të përfshirjes së studentëve në vlerësimin e procesit akademik përmes pyetësorësh në përfundim të çdo semestri.</p> <p>Nga shqyrtimi i disa modeleve pyetësorësh GVJ konstaton se studentëve Ju kërkohet të vlerësojnë sipas rubrikave:</p> <p><b>Lëndët e zhvilluara:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>1. Lëndë të përshtatëshme për programin e studimit</li> <li>2. Lëndë të vështira</li> <li>3. Lëndë të papërshtatëshme për programin e studimit.</li> <li>4. Lëndë që ju aftësojnë praktikisht</li> <li>5. Lëndë që përmbajnë informacion bashkëkohor</li> </ul>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	<p><b>Realizimin e orëve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>A. Realizimi i leksioneve</li> <li>B. Seminareve</li> <li>C. Diskutimeve</li> </ul> <p><b>Vlerësimin e performancës së personelit akademik:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>1. Përdorimin e metodave</li> <li>2. Motivimin e studentëve</li> <li>3. Vlerësimin e studentëve</li> <li>4. Respektin ndaj studentëve</li> </ul>
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës	<p><b>Vlerësimin e materialeve mësimore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>1. Materialet mësimore janë të përshtatëshme për lëndën</li> <li>2. Biblioteka është e pasur</li> <li>3. Interneti përdoret në funksion të mësimin</li> <li>4. Teknologjia mësimore përdoret në funksion të mësimin <b>[Shtojca 3.13. Modele pyetësorësh për studentët]</b></li> </ul> <p>Pyetësi studentor hartohet në bashkëpunim midis sektorit të kurikulave, sigurimit të cilësisë dhe NJSBC-së. Pyetësi siguron anonimat e studentit. GVJ konstatoi se institucioni jo vetëm që përfshin studentët në procesin e vlerësimit por vjel mendimin e tyre në çdo aspekt të procesit mësimor dhe infrastrukturës mësimore. Informacioni i grumbulluar është i bollshëm për të hartuar raporte të cilat analizojnë rezultatet e këtyre instrumentave në nivel të strukturave drejtuese.</p> <p>Nga shqyrtimi i planit mësimor të Programit Bch “Histori-Gjeografi” është vërejtur një ndarje e balancuar e ngarkesës mësimore në të gjashtë semestrat</p>

me nga 30 ECTS secili. Struktura e planit mësimor tregon që veprimtaritë leksion, seminare, praktika, provimi janë në vijueshmëri, merren në mënyrë të balancuar nga njëri semester në tjetrin dhe nga njëri vit në tjetrin. Praktikat zhvillohen në formën e ekspeditave në terren, në përfundim të vitit të parë dhe të dytë dhe kanë nga 3 kredite secila. Në varësi të peshës së njohurive që ka secila lëndë është bërë edhe shpërndarja e ngarkesës në kredite, që varion nga 4, 5, 6 kredite për lëndë. Të përkthyer në orë mësimore një student realizon në vit 1500 orë mësimore. **[Shtojca 2.7. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në HGJ]**

*GVJ konfirmoi edhe nga takimi me studentët gjatë vizitës në institucion që ngarkesa mësimore është e balancuar dhe nuk u krijote vështirësi në marrjen e njohurive në mënyrë graduale dhe të qëndrueshme. **[Takimi me studentët]*** Përfshirjen e studentëve në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit në bazë të rregullt vihet re në, realizimin e pyetësorit që iu bëhet studentëve në fund të çdo semestri. Në këtë pyetësor, ka një rubrikë e cila titullohet “Lëndët e zhvilluara”.



Në këtë rubrikë studentët nëpërmjet pyetjeve të shtruara në pyetësor japin mendimet e tyre lidhur me:

1. Lëndë të përshtatshme për programin e studimit
2. Lëndë të vështira
3. Lëndë të papërshtatshme për programin e studimit.
4. Lëndë që ju aftësojnë praktikisht
5. Lëndë që përmbajnë informacion bashkëkohor **[Shtojca 3.13. Modele pyetësorësh për studentët]**

*GVJ në takimin online me Drejtuesin e Departamentit u theksua rëndësia dhe vlera e përfshirjes së studentëve në procesin e vlerësimit të procesit akademik si dhe realizimi i mbledhjeve të departamentit në formatin e hapur ku ftohen dhe studentët. **[Takimi me Përgjegjësën e Departamentit HGJ]***

Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët si dhe nga kqyrja e dokumentacionit vërehet se studentëve u mundësohet transparencja dhe barazia në marrjen e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Në Rregulloren e Universitetit, përcaktohet procedura në rast ankese nga studenti. Sipas kësaj procedure, studenti realizon ankesën pas shpjegimeve përkatëse gjatë seancës sqaruese me pedagogun e lëndës. Studenti mund t'i drejtojë përgjegjësit të departamentit një kërkesë me shkrim, për rivlerësimin e komponentit përkatës në tezë. Përgjegjësi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngrë një komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar...etj. **[Rregullore UNIKO dhe FEF; Takimi me studentët; RVB]**

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht



**Standardi V.6**

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**



<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>								
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Njësia e posaçme që kryen informimin është zyra e informimit pranë FEF dhe sekretaria mësimore, të cilat ofrojnë shërbim ditorë të nevojave për shërbime nga ana e studentëve. Krahas tyre edhe QKA ofron shërbime për të gjitha kërkesat, paqartësitë, procesin e këshillimit, informimit dhe ndjekjen e studentëve.								
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Sistemi i online ESSE3 luan rolin e sekretarisë online. Ai bënë të mundur përmbushjen e të gjitha detyrimeve të procesit mësimor të parashikuara në rregulloren eUNIKO-n. <i>Edhe gjatë vizitës në sekretarinë mësimore dhe zyrën e informimit të FEF u vu re nga GVJ që informimi i studentëve kryhej në përputhje me aktet rregullatore të UNIKO.</i>								
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Rolin e njësisë për këshillimin e karrierës e luan Qendra e Karrierës dhe Alumni e cila zhvillon veprimtarinë e saj mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe Rregulloren e përgjithshme të UNIKO që prej vitit 2012. <b>[Shtojca 3.20. Analizë Vjetore Qendra e Karrierës dhe Alumni]</b> Format e shërbimit që QKA ofron për studentë janë Informin dhe orientim profesioanl siç është informimi për praktika profesionale. <b>[Shtojca 3.20. Analizë Vjetore Qendra e Karrierës dhe Alumni]</b>								
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Gjatë vizitës me përfaqësues të kësaj njësie dhe në takimin me studentët e programit Histor-Gjeografi mësuam për orientimin që kjo njësi u jep studentëve për realizimin e praktikave profesionale në institucionet arsimore lokale. Njëherazi prej studentëve morrën vlerësime rreth cilësisë së shërbimit prej kësaj njësie. <b>[Takimet me studentë, RVB, takimet me përfaqësues të QKA]</b> Raportet e gjurmimit të studentëve tregojnë për një procedurë të rregullt dhe sistematike të mbajtjes së kontakteve me studentët Alumni. Raportet gjithashtu tregojnë se procesi i gjurmimit të studentëve kryehet si nëpërmjet email-ve personale, telefonatave dhe faqes se QKA. <b>[Raportet e QKA, RVB]</b>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th><b>Nuk përmbushet</b></th> <th><b>Përmbushet pjesërisht</b></th> <th><b>Përmbushet kryesisht</b></th> <th><b>Përmbushet plotësisht</b></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>				<b>X</b>
<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
			<b>X</b>						

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

Adresa: "Ruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UNIKO janë të përcaktuara strukturat dhe procedurat për realizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Struktura që realizon këtë proces në nivel institucional është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). <b>[Statuti UNIKO Neni 73; Rregullore UNIKO]</b></p> <p>Standardet për sigurimin e cilësisë në UNIKO janë në përputhje me Kodin e Cilësisë, hartuar nga ASCAL dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve.</p> <p>UNIKO ka njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC) i cila ka për detyrë vlerësimin periodik të veprimtarisë mësimore e kërkimore. NJSBC ka akses në të gjitha të dhënat e UNIKO. Gjithashtu zyra e Standardeve dhe Cilësisë realizon politikat, strategjitë dhe proceset për të garantuar cilësinë në UNIKO. Institucioni angazhon dhe ekspertë të jashtëm pranë NJSBC-së.</p> <p><b>[Shtojca 1.4 – Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të cilësisë, dhe kërkimit shkencor, Shtojca 3.4 – Vendimi për r ngritjen e NJSBC në FEF]</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UNIKO përdor strukturat brenda tij për realizimin e sigurimit të cilësisë. Instrumenti që përdor UNIKO për sigurimin e cilësisë është “Manuali i Cilësisë” i cili specifikon parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në institucion në përputhje me kodin e cilësisë. Institucioni i është nënshtruar akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit në mënyrë të vazhdueshme. <b>[RVB]</b></p> <p>NJSBC administron, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm duke ftuar ekspertë të jashtëm për të trajnuar stafin që merret me vlerësimin e brendshëm. Në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë janë të përfshirë si bashkëpunëtorë të jashtëm studentët e diplomuar dhe punëdhënësit. <b>[RVB]</b></p> <p><i>Në takimin me përfaqësues të NJSBC në UNIKO dhe takimin me GVB, konkretisht, studentin që ishte pjesë e grupit të punës, u theksua realizimi dhe pjesëmarrjen e aktotëve të jashtëm në funksion të përmirësimit të cilësisë.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Institucioni ka politika dhe procedura të qarta për sigurimin e cilësisë. Struktura përgjegjëse NJSBC, programon punën në bazë të strategjisë/manualit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, dhe planit të veprimt të përvitshëm. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, propozuarat periodike që përdor për të siguruar cilësinë janë:</p> <p>A. Hartimi i raporteve periodike të vlerësimit të brendshëm</p> <p>B. Realizimi i procesit të matjes së perceptimit të studentëve nga SKCS-ja në bashkëpunim me NJSBC-në për cilësinë e mësimdhënies, për çdo program studimi në fund të çdo semestri.</p> <p>C. Realizimi i pyetësorëve me studentët nga pedagogët e lëndes, në përfundim të çdo semestri me qëllim vlerësimin e performancës së lektorit nga ana e studentëve.</p> <p>D. Hartimi dhe realizimi i analizës së punës mësimore-kërkimore në nivel</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Institucioni ka politika dhe procedura të qarta për sigurimin e cilësisë. Struktura përgjegjëse NJSBC, programon punën në bazë të strategjisë/manualit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, dhe planit të veprimt të përvitshëm. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, propozuarat periodike që përdor për të siguruar cilësinë janë:</p> <p>A. Hartimi i raporteve periodike të vlerësimit të brendshëm</p> <p>B. Realizimi i procesit të matjes së perceptimit të studentëve nga SKCS-ja në bashkëpunim me NJSBC-në për cilësinë e mësimdhënies, për çdo program studimi në fund të çdo semestri.</p> <p>C. Realizimi i pyetësorëve me studentët nga pedagogët e lëndes, në përfundim të çdo semestri me qëllim vlerësimin e performancës së lektorit nga ana e studentëve.</p> <p>D. Hartimi dhe realizimi i analizës së punës mësimore-kërkimore në nivel</p>

	<p>departamenti dhe fakulteti.  Rezultatet e marra nga monitorimi, analizat dhe raportet vihen në dispozicion të strukturave drejtuese të njësi bazë.  <b>[Strategji për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017 – 2022; Plani i veprimit NJSBC; RVB]</b>  <i>GVJ gjatë verifikimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion konfirmon realizimin e të gjitha proçeduarve periodike për vlerësimin e cilësisë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësi të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	Në nivel institucional struktura përgjegjëse për monitorimin e cilësisë, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programit të studimit është sektori i kurrikulës, vlerësimi institucional dhe alumni që janë ngritur brenda DKVI-së. Në nivel njësi bazë, është Departamenti që ka programin e studimit, i cili së bashku me strukturat e tij të brendshme si koordinatorët e programeve dhe përgjegjësit e grup-lëndëve është përgjegjës për sigurimin e cilësisë. <b>[RVB]</b>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	UNIKO përmes NJSBC-së realizon raporte vlerësimi periodike vjetore mbi elementë të ndryshëm të programeve të studimit në nivel Universiteti. Përmbajtja e këtyre raporte trajtohet në disa nivele brenda institucionit. <b>[RVB]</b> NJSBC nëpërmjet kontolleve të vazhdueshme të procesit mësimor, zbulon problematika të lidhura me përmbajtjen e kurrikulës dhe i referon ato departamentit për rishqyrtim. Në kuadër të objektivave të saj, NJSBC siguron bazën e të dhënave për cilësinë e mësimdhënies.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	Në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit, NJSBC mbikëqyr efikasitetin e kurrikulave, pasqyrimin e tyre me korrektësi në programet lëndore, në formatin e vlerësimit të miratuar, dhe në literaturën e vënë në dispozicion të studentëve. UNIKO dhe struktura përgjegjëse NJSBC përmes zbatimit të planit të veprimit të përvitshëm si dhe aktiviteteve me karakter monitorues nga Departamenti dhe njësia kryesore realizon vlerësimin në nivel institucional të të gjitha programeve të studimit. Ajo merr në shqyrtim:
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	A. Kontrollin e vazhdueshëm të realizimit të ngarkesës lëndore dhe pasqyrimin të saj në regjistrin e pedagogut. B. Monitorojnë përditësimin në mënyrë të vazhdueshme të dosjeve mësimore të personelit akademik, e cila është objekt kontrolli nga NJSBC.
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	



	<p>C. Kontrollon zbatueshmërinë e formateve të miratuara të syllabuseve lëndore në përputhje me <b>Udhëzimin Nr. 41, dt. 24. 01. 2018 të MASR.</b></p> <p>Raportet e realizuara nga NJSBC-ja janë në dispozicion të strukturave drejtuese dhe stafit. <b>[Manuali i veprimit NJSBC; RVB]</b></p> <p>Trajtimi i rezultateve të tyre në institucion bëhet në nivel Rektorati, Dekanati dhe Njësie Bazë.</p> <p>Bazuar në RVB-në, monitorimi i procesit të përmbushjes së masave në kuadër të mangësive të konstatuara realizohet nga NJSBC-ja nëpërmjet monitorimeve të vazhdueshme nga personat përgjegjës, autoritetet drejtuese, nga diskutimet me stafin akademik si dhe pyetësorëve.</p> <p>Në raportet e hartuara janë evidentuar dhe paraqiten këto mangësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Cilësia e materialeve mësimore (literaturës),</li> <li>2. Cilësia e performancës së personelit akademik,</li> <li>3. Komunikimi pedagog-student,</li> <li>4. Konceptimi i transparencës në vlerësim,</li> <li>5. Përputhja e materialit lëndor me format dhe mënyrat e vlerësimit,</li> <li>6. Raporti teori/ praktikë në kurrikula, etj.</li> </ol> <p>Mangësit ju bëhen me dije personelit akademik të departamentit të HGJ dhe në mbledhjet e organizuara në këtë njësi ato bëhen objekt i analizës vjetore. Nga takimi që GVJ pati me personelin akademik të njësisë konfirmoi jo vetëm realizimin e analizës rreth mangësive por edhe u njoh më konkretisht me disa prej masave që personeli akademik kishte marrë për përmirësimin e tyre siç ishte, shmangja e njohurive paralele në lëndë të përafërta, përmirësimin e formave të vlerësimit, ose shtimin e numrit të lëndëve me zgjedhje/ me karakter më praktik.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nota</b> Përmbushet përmbushet	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  <b>X</b>

<b>Standardi VI.3</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>  <b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë është garantimi i cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore, shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe financiare të UNIKO. NJSBC-ja realizon vlerësim periodik në nivel institucional tek të gjitha programet e studimit. Kjo strukturë nuk harton relacione specifike në bazë programi. Departamenti realizon analizë të përgjithshme për programin e studimit Bsc “Histori-Gjeografi”. <b>[Shtojca 3.7 – Raporti vjetor i NJSBC; RVB]</b>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të RVB-së dhe nga nga takimi më anëtarë të NJSBC konstatoam përdorimn e disa instrumentave për realizimin e procesit të vlerësimit si:</p> <p>1. Nëpërmjet anketimit realizohet vlerësimi për çdo lëndë të çdo pedagogu nga studentët;</p> <p>2. Përdorimi i fokus grupeve;</p> <p>3. Vlerësimi nga përgjegjësi i departamentit; <b>[Vizita në institucion; RVB]</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p><i>GVJ konsaton se përdorimi i metodave dhe instrumenteve për vlerësim janë në përputhje me natyrën e programit të studimit HGJ në FEF, UNIKO.</i></p> <p>Nga takimin online me përgjegjësin e departamentit dhe shqyrtimi i dokumentacionit na rezulton se institucioni përdor forma të ndërthurura për realizimin e vlerësimit dhe ruajtjes së cilësisë së programit të studimit. Për kategorinë lektor/asistent lektor realizohen monitorime nga ana e eprorëve dhe për këtë ka një format standard ku përfshihen komponentë si organizimi dhe qartësia e leksionit; komunikimi me studentët etj. Në përfundim të procesit hartohet një raport vlerësimi mbi rezultatet e monitorimit. Formatit i vlerësimit të performancës akademike të studentëve bëhet nga një ndërthurje instrumentash si testim me shkrim, detyra kursi, aktivizimi etj. <b>[Vizita në Institucion; Takimi online me PD, Stafin Akademik; Takimi me GVB; RVB]</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program</p>	<p>Institucioni kryen vlerësime periodike ku për çdo semestër realizon vlerësimin me studentët përmes anketimeve; fokus grupe; takime me stafin dhe studentë etj. NJSBC është struktura përgjegjëse për realizimin e procesit të vlerësimit. <b>[RVB]</b></p> <p>Krahas detyrës që kryen NJSBC departamenti i HGJ përdor instrumente të tërthorta vlerësimi lidhur me cilësinë e programit si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>A. Komente formale dhe joformale të studentëve,</li> <li>B. Takime me ish-studentë,</li> <li>C. Pyetësorë,</li> <li>D. Takime me Drejtorinë Rajonale Arsimore, Drejtues shkollash</li> <li>E. Sondazhe nga personeli akademik për lëndët që ata lektorojnë.</li> </ul> <p><i>GVJ nga takimi me personelin akademik te njësisë që zhvillon programin HGJ konfirmi realizimin e këtyre formave të tërthorta vlerësimi. Ata i konsideronin ato si një barometër të punës së tyre të përditëshme nga njëra anë por edhe si piketa për të vendosur prioritet në të ardhmen.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë</p>	<p>Sipas Rregullores së UNIKO, standardet dhe cilësia, përfshijnë disa struktura si:</p>



Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>a. Zyra e Standardeve dhe Cilësisë  b. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore-shkencore, të UNIKON-it. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të tij rregullohet me dokument të veçantë.  c. Zyra e Burimeve Njerëzore  d. Zyra e Kurrikulave.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>UNIKO realizon politika dhe procedura të brendshme të cilësisë duke përfshirë disa aktorë në proces si: bordet e tregut të punës; ekspert të jashtëm; përfshirja në projekte ndërkombëtare me fokus sigurimin e cilësisë së brendshme si Erasmus +. Përfshirja në këto projekte ka krijuar shkëmbime përvojash, trajnime, vizita studimore si dhe procese të tjera që lidhen me monitorimin dhe vlerësimin e funksionit e sigurimit të cilësisë së brendshëm. <b>[Rregullore UNIKO; RVB]</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Përgjegjësitë dhe detyrat e njësive të angazhuara janë të përcaktuara në kuadrin ligjor si Rregullore e UNIKO, rregullore e FEF, rregullore e DHGJ, mbi të cilin funksionon UNIKO dhe njësitë përbërse të tij. <b>[Rregullore UNIKO; RVB]</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin mbështetës GVJ i rezulton se ekzistojnë urdhëra të rektorit dhe vendime të drejtuesit të njësive bazë për detyra konkrete që njësitë dhe individët angazhohen në organizimin dhe menaxhimin e veprimtarisë kërkimore shkencore dhe koordinimin e saj sektorin e projekteve, kërkimit shkencor dhe të botimeve në UNIKO. <b>[Shtojca 2.8. Urdhëra për ngritjen e komisioneve në Departament]</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>NJSBC-ja nuk realizon raporte në nivel program studimi. Gjatë procesit të realizimit të pyetësorit ajo përfshin në sondazhet për vlerësim të gjithë personelin akademik, studentët e Departamentit të HGJ dhe personelin ndihmës akademik. Gjithashtu, siguri i cilësisë së programit bëhet objekt analize çdo fund viti akademik nga vetë njëzia bazë që e ofron programin HGJ, nga departamenti.</p> <p>UNIKO ka disa standarde të cilat i respekton për përzgjedhjen e anëtarëve në procesin e vlerësimit-NJSBC-së (si: kompetenca profesionale, paanshmëria, përfaqësimi për çdo njësi, rotacioni ...etj). Bazuar në RVB fq.61 anëtarët e NJSBC për njësinë kryesore nuk duhet të jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të universitetit, etj. <b>[RVB]</b></p> <p>Nga RVB nuk është shumë e qartë nëse ka bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit dhe që marrin pjesë në vlerësimin e brendshëm të cilësisë. <b>[RVB]</b></p> <p><i>Gjithashtu GVJ konstaton mungesë të dokumentacionit mbështetës lidhur me rolin që ekspertiza e jashtme duhet të japë në vlerësimin e cilësisë për programin e studimit HGJ.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi VI.5**  
**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vepron në bazë të një plani veprimi vjetor të miratuar nga Rektori i Institucionit UNIKO. Rregullorja e NJSBCS është dokumenti në të cilin përcaktohen rregullat e organizimit të veprimtarisë në kuadër të sistemit të brendshëm të cilësisë. Këto dokumenta sikundër pranohet në RVB dhe "...raportet e NJSBC-së përmbajnë të dhëna sensitive dhe personale, ato bëhen pjesë e diskutimeve në ato grupe për të cilat raporti ka ndikim të drejtpërdrejtë" [Rregullore e NJSBC; RVB]			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Vlerësimi kryhet në nivel institucional, dhe rezultatet e tij iu bëhen me dije strukturave drejtuese. Struktura drejtuese i përcjell rezultatet në njësinë bazë dhe ato element që lidhen me këtë njësi. Në departament trajtohet me stafet akademike ato elementë të vlerësimit që lidhen ngushtë me veprimtarinë e tyre. Raportet e NJSBC-së nuk janë të aksesueshme për të gjithë stafin akademik e aq më pak për studentët. Kjo sepse publikohen pjesë të shkëputura të raportit. [RVB]			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ sygjeron që një përmbledhje e rezultateve të raportit dhe masave propozuese, të jenë publike dhe e aksesueshme për stafin akademik por edhe për studentët e më gjerë.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni realizon në vijueshmëri procesin e përpilimit të rezultateve dhe masave që duhet të ndërmerren si rezultat i raportit. Sipas RVB-së disa nga masat e marra lidhen me aktivitete për ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve akademike përmes realizimit të seminareve të trajnimit me natyrë didaktike të mësimdhënies apo për kërkimin shkencor.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Përpjekjet për të reflektuar gjetjet e raportit sikundër dhe monitorimin janë në nivel institucional. Përmes kontrollit të kryqëzuar, strukturat dhe aktorë të brendshëm të UNIKO reflektojnë mbi rezultatet e raportit dhe realizojnë masa që lidhen me programet e studimit për ta përmirësuar më tej. [RVB]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>



**Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor  
në “Histori-Gjeografi” të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Fan  
S. Noli” Korçë**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Universiteti “Fan.S.Noli” Korçë (UK) është një institucion publik relativisht me një jetë prej 50 vitesh dhe kjo përbën një përvojë të konsiderueshme në ndarjen e detyrave për mbarëvajtjen e programit në Bch në “Histori-Gjeografi”.
2. Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë përmbush detyrimet ligjore përsa i përket strukturës akademike, kualifikimeve të stafit, ngarkesës mësimore në auditor të detyrueshme sipas kategorive përkatëse të personelit akademik.
3. Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë përmbush të gjithë detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënljigjore duke ushtruar kompetenca të plota mbi mbarëvajtjen e mësimit dhe kërkimit
4. Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë përfshin personel akademik të kategoris të “Ftuar” me një formim më të lartë se cikli paraardhës duke përmbushur detyrimin ligjor.
5. Përmbajta e programit BCH në “Histori-Gjeografi” u krijon mundësi studentëve të thellohen në ciklin e dytë të studimeve, Master Profesional ose Master i Shkencave në fusha si Histori dhe Gjeografi.
6. Njësia e Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë kreyen praktikia të qarta dhe konkrete dhe me efikasitet në vlerësimin e cilësisë së brendëshme në nivel institucional.
7. Infrastruktura dhe baza materiale në auditore dhe laboratore, në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve, lejon dhe mundëson aplikimin efektiv të metodave të shumëllojshme të mësimdhënies.
8. Shpërndarja e aktiviteteve me karakter praktik dhe teorik në planin e programit të studimit i shërben studentëve për thellimin e njohurive dhe krijimin e kushteve të duhura për një kompetencë të nevojshme në të ardhmen.
9. Praktikata e informimi të studentëve lidhur me proceduarat e vlerësimit janë të larmishme dhe të shtrirë në disa plane. Kjo vlerësohet si një punë shumë e mirë që bëhet nga ana e institucionit për vrojtimin në mënyrë sistematike të masës me të cilën përmbushet marrja e informacionit nga studentët.
10. Institucioni UNIKO përfshin studentët e programit të studimit në BCH në “Histori-Gjeografi” në procesin e vlerësimit dhe vjel mendimin e tyre në çdo aspekt të procesit mësimor dhe infrastrukturës mësimore. Informacioni i grumbulluar është i bollshëm për të hartuar raporte të cilat analizojnë rezultatet e këtyre instrumentave në nivel të strukturave drejtuese.
11. Metodatat e mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit vlerësohen nga njëra anë si barometër i punës së përditëshme të personelit akademik por edhe si piketa për të vendosur prioritetet në të ardhmen.

**Pika të dobta**

1. Mungesa e studimit të tregut të punës që të orientoj hapjen dhe zhvillimin e programeve të studimit në tërësi apo specifikisht për programin e studimit Bch në “Histori-Gjeografi” në mënyrë që të reflektoj zhvillimin e programit të studimit në harmoni me zhvillimet social-ekonomike të vendit, apo politikat rajonale të Qarkut të Korçës.
2. Moskryerja e kodifikimit të programit të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.







3. Programi i studimit, që ofrohet nuk ka përmbajtje të ngjashme në nivel kombëtar, së paku 70 për qind”, duke u bërë penges në mobilitetin brenda vendit, por edhe me gjerë.
4. Lista e disiplinave me zgjedhje nga studenti të kategorisë (C) në programin mësimor të programit të studimit Bch në “Histori-Gjeografi” është e varfër. Në gjendjen aktuale mundësitë për përzgjedhje janë të kufizuara.
5. Në programin mësimor të programit të studimit Bch në “Histori-Gjeografi” mungon titullari i lëndës me kategorinë Profesor.
6. Mosfunksionimi i faqes zyrtare të universitetit online.
7. Titujt e librave në lëmin e Gjeografisë janë të pakët në numër krahasuar me ato në lëmin e Historisë dhe nuk u përkasin pesë viteve të fundit sipas kërkesave dhe udhëzimeve ligjore.
8. Mungesë e mbështetjes financiare të punës kërkimore të personelit akademik me qëllim nxitjen e tij në rritjen cilësore profesionale që do të reflektohet në të ardhmen në mësimdhënie cilësore dhe konkurrese
9. Numër i vogël i studentëve që frekuentojnë këtë program studimi.
10. Fondi i bibliotekës reflekton mungesë të titujve me autorë të huaj si në lëmin e gjeografisë ashtu edhe historisë dhe të pesë viteve të fundit.

### Rekomandime

1. Rekomandohet që Departamenti Histori-Gjeografisë njësi bazë e FEF-së, njëkohësisht si struktura që ligji 80/2015 i jep të drejtën e përgjegjësisë së programeve të studimit (ndryshe nga ligji i vjetër që ja jepte këtë të drejtë Fakultetit) të kryejë një studim të përgjithshëm mbi nevojat e tregut të punës në lidhje me programet që ajo ofron (ku të përfshihet dhe programi Bsc Histori-Gjeografi).
2. Rekomandohet të shtohen numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit së pari, brenda vendit dhe më pas edhe me institucionet rajonale dhe me gjerë me qëllim funksionimin e këtij programi.
3. Rekomandohet që të gjitha veprimtaritë që kryhen (aq sa janë deri tani, por që në të ardhmen mund të shtohen) në kuadër të realizimit të proceseve akademike dhe administrative në funksion të programit të studimit, të ruhen, administrohen, analizohen dhe raportohen në përputhje me aktet e brendshme të miratuara nga ana e institucionit.
4. Rekomandohet bërja funksionale e njësisë të sigurimit të cilësisë, në rang fakulteti duke u mbështetur tek përvoja shumë e mire e funksionimit të DKVI-së .
5. Rekomandohet që UNIKO duhet të rrisë mbështetjen financiare për pasurimin e Bibliotekës së UK dhe Bibliotekës së Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë me literaturë në fushën e shkencave humane dhe ato sociale, sidomos në gjuhë të huaj në fushën e Historisë dhe Gjeografisë.
6. Rekomandohet hartimi i raporteve financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe të planifikohen ndërhyrjet e posaçme të financimit për programin e studimit
7. Rekomandohet publikimi i përmbledhjeve të rezultateve të raportit dhe masave propozuese të NJSBC, të jenë publike dhe e aksesueshme për stafin akademik por edhe për studentët e më gjerë.
8. Rekomandohet që në të ardhmen Departamenti i Histori-Gjeografisë të zhvillojë një aktivitet kërkimor shkencor një herë në vit në fushën e programit të studimit që po akreditohet.
9. Rekomandohet që institucioni UK duhet të kontribuojë më shumë në trainimin e anëtarëve të personelit akademik të DHG, veçanërisht në programet ERASMUS+, në fushën e trainimit dhe shkëmbimet për mësimdhënie në universitetet analoge.
10. Rekomandohet që institucioni UK duhet të kontribuojë më shumë në përfshirjen e studentëve të programit të studimit në programin ERASMUS+ në kuadër të ndërkomtarizmit të institucioneve të arsimit të lartë.



**Conclusions of the evaluation for the study program of the first cycle**  
**Bachelor in "History-Geography" of the Institution of Higher Education**  
**University "Fan S, Noli" Korça**

**Strengths and Affirmations**

1. University "Fan.S.Noli" Korça (UK) is a public institution with a relative life of 50 years and this is a considerable experience in the division of tasks for the progress of the program in Bch in "History-Geography".
2. The Department of History and Geography fulfills the legal obligations regarding the academic structure, the qualifications of the staff, the teaching load regarding the obligatory auditorium according to the respective categories of the academic staff.
3. The Department of History and Geography fulfills all the obligations deriving from the legal and sub-legal acts by exercising full competencies on the progress of teaching and researching.
4. The Department of History and Geography includes academic staff of the category "Guest" with a higher education than the previous cycle, fulfilling the legal obligation required.
5. The content of the BCH program in "History-Geography" creates opportunities for students to deepen their knowledge in the second cycle of studies, Professional Master or Master of Science in fields such as History and Geography.
6. The Internal Quality Assurance Unit conducts clear and concrete practices that are effective in the evaluation of internal quality at the institutional level.
7. The infrastructure and material base in auditoriums and laboratories, available to academic staff and students, allows and enables the effective application of various teaching methods.
8. The distribution of practical and theoretical activities in the study program plan serves students to deepen knowledge and create the right conditions for a necessary competence in the future.
9. Student information practices regarding assessment procedures are varied and spread over several planes. This is considered as a very good job done by the institution for the systematic observation of the extent to which the receipt of information by students is fulfilled.
10. UNIKO Institution includes the students of the study program in BCH in "History-Geography" in the evaluation process and collects their opinion in every aspect of the teaching process and teaching infrastructure. The information gathered is abundant to compile reports which analyze the results of these instruments at the level of management structures.
11. The methods of improving the quality of the study program are evaluated on the one hand as a barometer of the daily work of the academic staff but also as milestones to set priorities in the future.

**Weaknesses**



1. Lack of labor market study to orient the opening and development of study programs in general or specifically for the Bch study program in "History-Geography" in order to reflect the development of the study program in line with social developments- economic development of the country, or regional policies of the Korça Region.
2. Failure to codify the study program according to national and European directives and guidelines.
3. The study program that is offered does not have similar content at the national level, at least on 70i percent ", becoming an obstacle to mobility within the country, but also beyond.



4. The list of elective disciplines by category (C) students in the Bch's History-Geography curriculum is poor. In the current situation the options for selection are limited.
5. In the curriculum of the Bch study program in "History-Geography" is missing the conductor of the course with the category Professor.
6. Malfunction of the official website of the online page of university.
7. Book titles in the field of Geography are few in number compared to those in the field of History and do not belong to the last five years according to legal requirements and instructions.
8. Lack of financial support for the research work of the academic staff in order to raise the professional growth that will be reflected in the future in quality and competitive teaching
9. Small number of students attending this study program.
10. The library fund reflects the lack of titles with foreign authors in the field of geography as well as history over the last five years.

### Recommendation

1. It is recommended that the Department of History-Geography, the basic unit of the FEF, at the same time also as the structure, that law 80/2015 gives it the right of responsibility of study programs (unlike the old law that gave this right to the Faculty) to perform a general study on the needs of the labor market in relation to the programs it offers (including the Bsc History-Geography program).
2. It is recommended to increase the number of cooperation agreements, first within the country and then with regional institutions and beyond in order to operate this program.
3. It is recommended that all activities carried out (as many as there are until now, might be added in the future) in the framework of the implementation of academic and administrative processes in function of the study program, be stored, administered, analyzed and reported in compliance with internal acts adopted by the institution.
4. It is recommended to make the quality assurance unit functional, at the faculty level, based on the very good experience of DKVI functioning.
5. It is recommended that UNIKO should increase the financial support for the enrichment of the UK Library and the Library of the Faculty of Education and Philology with literature in the field of humanities and social sciences, especially in foreign languages in the field of History and Geography.
6. It is recommended to draft financial reports for the past three academic years and to plan special funding interventions for the study program.
7. It is recommended to publish summaries of the results of the report and the proposed measures of the IUBC, which must be public and accessible to the academic staff but also to students and beyond.
8. It is recommended that in the future the Department of History-Geography to conduct a scientific research activity once a year in the field of the study program that is being accredited.
9. It is recommended that the UK institution should contribute more to the training of DHG academic staff members, in particular ERASMUS + programs, in the field of training and teaching exchanges at analogue universities.
10. It is recommended that the UK institution should contribute more to the inclusion of study program students in the ERASMUS + program in the framework of the internationalization of higher education institutions.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

